

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË ALBPETROL SHA PATOS

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Albpetrol Sha Patos me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë nga 01.07.2014 deri me datë 30.06.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.138, datë 30.09.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 494/19, datë 05.10.2015, dërguar z. Endri Puka, Administrator, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Shoqëria Albpetrol SHA nuk ka plotësuar dhe dërguar në Ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V “Shtojcat”, Shtojca 2 – Pyetësi i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së.

-nuk ka hartuar dhe miratuar planin strategjik i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit;

-nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara;

-nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre;

-nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS);

-nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit, nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut;

-nuk ka miratuar ndarje detyrash dhe përgjegjësi në nivel shef sektorësh dhe specialisti. Nuk ka përshkrime detyrash individuale, e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesa lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës. Nuk ka vlerësime periodike të punonjësve lidhur me detyrat që kryejnë ato. Nga administratori i Shoqërisë nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit;

- nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave;

-nuk ka informacion të vazhdueshëm për Titullarin për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave;

-Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve nuk janë trajnuar punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës dhe vetë njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë), paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”;

-nuk ka hartuar gjurmët e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj;

-në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit, brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave (trajtuar më hollësisht në faqet 155-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

-Shoqëria Albpetrol SHA, të miratojë rregulloren për zbatimin e Kodit të Etikës konform legjislacionit në fuqi, duke përcaktuar njëkohësisht masat disiplinore dhe strukturat vendimmarrëse për punonjësit shkelës të rregullave të etikës.

-Shoqëria Albpetrol SHA të marrë masat e duhura për të bërë ndryshimin e rregullores së brendshme në përshtatje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe në përputhje me strukturën organike të shoqërisë me qëllim që, të mos ketë ndryshime midis strukturave të përcaktuara sipas organikës me ato të përcaktuara në rregullore. Me akte administrative të brendshme, të përcaktojë delegimin e kompetencave apo të detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

-Shoqëria Albpetrol SHA të marrë masat e duhura për të miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), i cili ka për qëllim të diskutojë çështjet kryesore dhe mangësitë serioze me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave, si dhe të caktojë nëpunësin zbatues dhe nëpunësin autorizues që është përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxheteve të tyre.

-Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, shoqëria të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar Strategjinë e riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

-Për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, Shoqëria krahas trajnimeve të kryera, të hartojë dhe programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, punonjësit të trajnohen dhe për kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij, në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe se, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk ka funksionuar në këtë njësi. Gjithashtu, shoqëria të hartojë një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre, si dhe të bëjë dhe vlerësimin e punës së punonjësve.

-Me qëllim që të ndihmohet menaxhimi për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

Deri me datë 31.12.2015

Në lidhje me funksionimin e auditit të brendshëm.

Albpetrol SHA nuk ka marrë masa si më poshtë:

-Nuk është hartuar manuali specifik dhe karta e Auditit të Brendshëm të Albpetrol SHA;

-Nuk ka asnjë informacion nga subjektet në lidhje me pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve, pasi në një pjesë të rasteve nuk ka shkresë përcjellëse të vënies në dispozicion të tyre;

-Mungojnë në disa dosje programet e punës për angazhimet (misionet) e auditimeve të kryera.

-Nuk është bërë ndarja e detyrave dhe përcaktimi i përgjegjësive individuale të audituesve gjatë angazhimit të auditimit;

-Ka mungesa në hartimin e dokumenteve të auditimit, si: mungojnë njoftimet për fillimin e angazhimit, takimet me palën e audituar, ndryshim periudhe auditimi etj.;

-Dosjet nuk janë të arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” (trajtuar më hollësisht në faqet 157-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës, Administratori Shoqërisë dhe Drejtorja e Auditit të Brendshëm, të marrin masa për hartimin e manualit specifik dhe kartës së Auditit të Brendshëm të Albpetrol SHA, zbatimin e standardeve të auditimit në organizimin, funksionimin, rekrutimin e stafit dhe në të gjitha fazat e procesit të auditimit, në zbatim të Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe UMF nr. 12 datë 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Deri me datë 31.10.2015

-Masat organizative, disiplinore, për shpërblim dëmi etj, të cilat rekomandohen nga ana e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të Shoqërisë Albpetrol SHA dhe miratohen nga Administratori, duhet të jenë në proporcion me gjetjet e auditimit.

-Dosjet të arkivohen, të gjitha mbas evadimit të materialit dhe vendimit për miratimin e Raportit Final dhe Memorandumit të firmosur nga administratori i shoqërisë, konformë me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Vazhdimisht

2. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

1. Shoqëria Albpetrol Sha nuk i ka zbatuar në mënyrë të plotë rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së. Nga masat organizative, 4 masa janë realizuar, 8 masa janë realizuar pjesërisht ose në proces realizimi, ndërsa 23 masa të tjera nuk janë realizuar ose nuk janë pranuar të realizohen nga ana e strukturave drejtuese të Albpetrol SHA. Nga 9 masa për shpërblim dëmi, nuk janë zbatuar 3 të tilla, ndërsa 6 masa janë në proces realizimi. Në lidhje me masat disiplinore, janë rekomanduar gjithsej 6 masa “Zgjidhje të kontratës së punësimit” dhe 18 masa “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate”, por nuk është zbatuar asnjë masë e tillë. Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë, me vendimet e tyre, kanë vendosur për mos-zbatimin e plotë të rekomandimeve (trajtuar më hollësisht në faqet 30 - 42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i Shoqërisë Albpetrol SHA, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat rezultuan ende të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme rekomandimet të cilat janë në procese gjyqësore.

Këshilli Mbikëqyrës të analizojë Raportin Përfundimtar dhe rekomandimet e auditimit të mëparshëm në mbledhjen më të afërt dhe të raportojë me shkrim në KLSH mbi arsyet e mos zbatimit të këtyre masave. Më tej KLSH do analizojë këtë material të Këshillit Mbikëqyrës dhe do t'i drejtohet organeve më të larta shtetërore të kompetencës si dhe atij të prokurorisë, në se do të jetë e nevojshme, sipas përcaktimit në Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Neni 15.

Deri me datë 31.10.2015

3. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore.

Administratori i shoqërisë Albpetrol SHA, nuk ka respektuar procedurat e parashikuara në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, lidhur me rastet e pushimit kolektiv. Gjithashtu, nuk është rinovuar kontrata kolektive e punës.

-Kontrata kolektive ka parashikuar, të gjitha kushtet e marrjeve në punë dhe zgjidhjeve të kontratave të punës, por vazhdimisht shoqëria ka paguar penalitete për shkak të vendimeve të Gjykatave, që kanë dalë si pasojë e disa zgjidhjeve të padrejta të kontratave të punonjësve. Për sa trajtuar në Raport, ky veprim ka sjellë penalizimin e shoqërisë nga ankimet në Gjykatë, me

një vlerë 26,737,207 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Megjithatë largimi padrejtësisht nga puna i punonjësve është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm, nga ana e Albpetrol SHA nuk janë marrë masa për rikthimin në punë të tyre (trajtuar më hollësisht në faqet 44-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrin masa për të rinovuar kontratën kolektive të punës të punonjësve nr. 1655 prot, datë 30.05.2012, në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Nga Albpetrol SHA, për çdo rast të largimit të punonjësve nga detyra të zbatohen dispozitat ligjore, duke marrë njëkohësisht konfirmimin e procedurës nga Drejtoria Juridike, e cila është përgjegjëse për ndjekjen e procedurave ligjore të gjykimit në rastet e ankimimeve si dhe për rikthimin në punë të gjithë punonjësve të larguar pa të drejtë.

Menjëherë

4. Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomiko-financiar. Ndjekja dhe realizimi i treguesve ekonomiko-financiarë në qendër dhe filiale.

Nga auditimi rezulton se në Albpetrol SHA, programi ekonomiko-financiar për vitin 2014, paraqitet me një mosrealizim në vlerën 565 milion lekë, në një kohë që dhe programi ekonomiko financiar për vitin 2015 është bërë subjekt i ndryshimeve të shpeshta, të paargumentuara nga Shoqëria dhe të pa rekomanduara nga Ministria e Linjës (MEI) dhe Asambleja e Aksionarit. Drejtuesit e Albpetrol SHA nuk kanë analizuar siç duhet treguesit ekonomiko-financiar, duke bërë programime të pa bazuara si pasojë e të cilit janë bërë ndryshime të shpeshta. Mos realizimi i investimeve për vitin 2014 ka ndikuar negativisht në rritjen e të ardhurave të shoqërisë, kjo e përforcuar edhe me faktin e mungesës së infrastrukturës së depozitimit të naftës brut. Ky problem duhet të ishte analizuar me hollësi, duke përcaktuar rrethanat dhe përgjegjësitë (trajtuar më hollësisht në faqet 49-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Programimit, të marrin masa për hartimin e programit ekonomiko-financiar me tregues të harmonizuar dhe të bashkërenduar, duke ndjekur të gjitha fazat përkatëse, si dhe periodikisht të analizojë ecurinë e tyre, duke përcaktuar masa konkrete për përmirësimin e gjendjes dhe realizimin e tyre. Të merren masa për programimin dhe realizimin e investimeve duke përcaktuar saktë prioritetet për ndërhyrje, me synim arritjen e përfitimeve nëpërmjet tyre dhe rritjen e të ardhurave të Shoqërisë.

Vazhdimisht

5. Mbi organizimi dhe mbajtjen e evidencave kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi e miratimi i tij në organet e vartësisë.

5.1. Pasqyrat financiare të paraqitura nga qendrat administrative në vartësi të Albpetrol SHA nuk janë paraqitur zyrtarisht, nuk kanë konfirmimet e drejtuesve të qendrave, nuk kanë relacion shoqërues dhe sqarues të plotësimit të tyre, nuk kanë të konfirmuar afatin e dorëzimit dhe shpesh here janë dhe pa konfirmimet e shefave të financës, në kundërshtim me aktet në fuqi, duke i bërë këto pasqyra të pabesueshme. Gjithashtu ka rezultuar se, pasqyrat përmbledhëse financiare të Albpetrol SHA u janë paraqitur me vonesë ekspertëve dhe për pasojë këto pasqyra nuk kanë marrë miratimin përkatës konform ligjit sipas shkallës hierarkike, duke çuar në faktin e paraqitjes të tyre në organet tatimore, jashtë afateve të përcaktuara në ligj. Me synim rregullimin e këtij procesi, konform rregullave dhe dispozitave ligjore në fuqi këto pasqyra duhet të paraqiten për miratim në kohën e duhur (trajtuar më hollësisht në faqet 52-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Administratori i Albpetrol SHA të iniciohet, mbi bazën e propozimeve të Drejtorisë së Financës në zbatim të nenit 9/2 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, miratimi i akteve të brendshme administrative, brenda kuadrit rregullator të Ministrisë së Financave, ku të përcaktohen në mënyrë të hollësishme, rregullat e hartimit dhe paraqitjes, afatet, përgjegjësitë dhe konfirmimet e pasqyrave financiare.

-Të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë për vonesat e shkaktuara në realizimin dhe paraqitjen e pasqyrave financiare për miratim në strukturat përkatëse ligjore.

Vazhdimisht

5.2. Janë përdorur norma të amortizimit të miratuara me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 24, datë 30.04.2007, të cilat janë të ndryshme nga normat amortizimit të përcaktuara në ligjet në fuqi, për efekte tatimore dhe njëkohësisht janë norma që nuk i përshtaten aktualitetit, duke veçuar në mënyrë të veçantë amortizimin prej 3 % të aktiveve të kategorisë “Kompjuterë, sisteme informacioni, produkte "software" dhe pajisje të ruajtjes së të dhënave”, që rezultojnë pa argumentuar (trajtuar më hollësisht në faqet 55-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës së Albpetrol SHA referuar një analize të hollësishme të shpenzimeve për mirëmbajtjen e aktiveve si dhe nevojave për përdorim të aktiveve në cilësinë dhe efektivitetin e duhur, të propozojë në Këshillin Mbikëqyrës për ndryshimin e normave të amortizimit, në reference të normave të amortizimit të miratuara nga ligji për efekte tatimore.

Deri me datë 31.10.2015

5.3. Në kundërshtim me SKK 13, në pasqyrat financiare të Albpetrol SHA nuk janë përfshirë në aktivet afatgjata “aktive biologjike” dhe “aktive të tjera” (që përfaqësojnë banesa, k/parti) për rrjedhojë kundrejt tyre nuk janë aplikuar norma amortizimi, gjithashtu referuar faktit se aktivet e Albpetrol SHA janë rivlerësuar me VKM në vitin 2005 dhe përfshirë vlera e rivlerësimit në pasqyrat financiare të vitit 2007 në llogarinë rezerva rivlerësimi “llog 105” me vlerë 29,537,324,907 lekë dhe llogari me emërtim prime të kapitalit (aksionit) “llogari 104” me vlerë 14,128,241,440 lekë, por këto vlera nuk i janë bashkuar kapitalit aksionar, në kundërshtim me standardet në fuqi, ku nga aksionari nuk ka vendimmarrje për këtë qëllim deri në fund të vitit 2014 (trajtuar më hollësisht në faqet 54-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Financës të kryhet sistemimi gjatë vitit 2015 i pasqyrimin dhe përllogaritjes së amortizimit të aktiveve biologjike dhe banesave në rubrikën e aktiveve afatgjata.

Në konsultim me ekspertët kontabël të miratuar për rivlerësim, me urdhrin e Ministrit të MZHEHTS nr. 140, datë 20.02.2015 “Për rivlerësimin e Aseteve të Shoqërisë Albpetrol SHA Patos”, të përcaktohet mënyra e pasqyrimin të vlerës së rezultuar nga rivlerësimi i mëparshëm dhe mbi këtë bazë të bëhet kërkesa kundrejt aksionarit për ndryshim të kapitalit aksionar të shoqërisë, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Deri me 31.12.2015

5.4. Nga Albpetrol SHA janë miratuar gjatë vitit 2014 dhe 2015, sipas procedurave, dhënia e sponsorizimeve, ku një pjesë e përfituesve kanë tërhequr fondet e sponsorizimit, por dokumentacioni justifikues i shpenzimit është i pa mjaftueshëm për të justifikuar shpenzimin, pasi ka vetëm një faturë të thjeshtë tatimore të lëshuar nga subjekti përfitues të sponsorizimit me emërtimin e projektit. Gjithashtu, nga Albpetrol SHA nuk është kryer auditim në shoqërinë përfituese në lidhje me përdorimin e shumës së sponsorizuar në përputhje me veprimtarinë e kërkuar për sponsorizim, kjo e drejtë e dhënë nga neni 4 pika 4 e kontratave të lidhura (trajtuar më hollësisht në faqet 54-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga Albpetrol SHA, në zbatim të përcaktimeve në nenin 4 të kontratave të lidhura me subjektet përfituese të sponsorizimit: për shumën prej 500,000 lekë dhe për

shumën 700,000 lekë për realizimin e koncertit të Butrintit, për të cilin është sponsorizuar menjëherë me paradhënie 100 %, të kryhet auditimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm konform qëllimit të sponsorizimit dhe dokumentacionit ligjor justifikues, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Deri më datë 30.11.2015

5.5. Nga Albpetrol SHA janë transferuar fonde në formën e huas, në kundërshtim me ligjet në fuqi, por në zbatim të urdhrat të ministrit të MZHETTS nr. 545, datë 12.12.2014, për 6 shoqëri me kapital shtetëror në shumën 20,176,592 lekë. Për huadhënien këtyre subjekteve nuk ka komunikim elektronik me ministrinë, e cila ka përcaktuar se këto shuma do të rimbursohen nga buxheti i shtetit për vitin 2015. Deri në momentin e auditimit nuk rezulton që këto shuma të jenë disbursuar si dhe nuk ka asnjë konfirmim për përfshirjen e tyre në fondet e miratuara për vitin 2015. Nisur dhe nga fakti që Albpetrol-SHA ka detyrime dividend të pa derdhur në buxhet të shtetit vlera e mësipërme duhet të skedulohej dhe të zbritet nga detyrimi “Divident” në shumën prej 2,712,802,377 lekë që Albpetrol SHA i ka buxhetit të shtetit (trajtuar më hollësisht në faqet 58-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

-Nga Albpetrol SHA të iniciohet komunikimi zyrtar me MZHETTS për rimbursimin e menjëhershëm të shumave të pranura për rimbursim me fondet e vitit 2015, në të kundërt shumat e pa rimbursuara prej 20,176,592 lekë së bashku me shumën e pa rimbursuar prej 288 milionë lekë, kaluar si transfertë në zbatim të pikës 5 të Vendimit të KM nr. 660, datë 12.09.2007 dhe të pa rimbursuar deri në periudhën e auditimit, të skedulohen dhe të zbriten nga detyrimi “Divident” në shumën prej 2,712,802,377 lekë që Albpetrol SHA i ka buxhetit të shtetit.

Deri më datë 31.10.2015

5.6. Drejtoria e Financës së Albpetrol SHA kryen veprimet e transaksioneve financiare (pagesa arkëtime) nëpërmjet një numri të konsiderueshëm të llogarive bankare, në lekë dhe në valutë. Referuar konstatimit se një sasi e konsiderueshme e këtyre llogarive rezultuan pa transaksione financiare gjatë vitit 2014 – 6 mujori i parë 2015, ose me pak transaksione (një ose dy), në një kohë që për mbajtjen e hapur të llogarive paguhen komisione shërbimi në lekë apo valutë, për efekt të një menaxhimi më të mirë, të përqendruar dhe për efekt të eliminimit të shpenzimeve dhe kostove jo efektive duhen marrë masa për mbylljen e tyre (trajtuar më hollësisht në faqet 61-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Financës së Albpetrol SHA, referuar një analize të efektivitetit dhe interesave për çdo llogari të hapur, të fillojnë procedurat e mbylljes së llogarive bankare pa aktivitet gjatë viteve të fundit dhe të pa nevojshme për shoqërinë.

Deri më datë 30.11.2015

5.7. Nga auditimi rezulton se, ka mangësi të theksuara në lidhje me administrimin dhe ruajtjen e pronës shtetërore në administrim të Albpetrol SHA me pasojë vjedhjen e rërës bituminoze në masën 22,379 ton dhe në vlerën kontabile 16,104,670 lekë të rezultuar si mungesë inventariale në pasqyrat financiare të vitit 2014 dhe të identifikuar në procesverbalet e inventarëve të kryera për qendrën QPN Patos.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se nga administratori i shoqërisë dhe drejtuesi i qendrës për ngjarjen e ndodhur dhe të pretenduar si vjedhje, e cila ka ndodhur në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve 2012, 2013, 2014, nuk ka marrje masash për ngritjen e një sistemi të sigurt ruajtje dhe mbrojtjeje të aktiveve në zbatim të akteve në fuqi, nuk ka nxjerrje përgjegjësish, nuk ka ndjekje, ose denoncime hap pas hapi në organet kompetente dhe në rastet e hapjes së çështjeve penale shumë kohë pas fakteve të ndodhura, argumentet bazë të denoncimeve nuk janë shoqëruar me dokumente vërtetues, por vetëm mbi baza hipotezash. Për këtë arsye çdo herë kallëzimet penale janë pushuar nga prokuroria. Gjithashtu dhe për çështjen penale të hapur nga Albpetrol SHA për mungesën e rërës bituminoze në inventar të Shoqërisë

sipas bilancit të vitit 2014, çështja penale e hapur prej tyre nuk përfshinte gjithë sasinë e munguar të rërës bituminoze si dhe nuk identifikonte personat përgjegjës (Trajtuar më hollësisht në faqet 63-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë.

Albpetrol SHA si dhe QPNGR, të ndjekin procedurat ligjore dhe të marrin masa të vazhdueshme për ruajtjen dhe administrimin e aseteve materiale, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Vazhdimisht

6. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në veprimet e arkës dhe bankës në lekë e valutë, si dhe blerjet me vlera të vogla.

Blerjet me vlera të vogla janë kryer pa u hartuar më parë kërkesat vjetore për mallra e shërbime, pa u bërë specifikimi i saktë i mallrave dhe i materialeve që janë prokuruar, si dhe pa u argumentuar nevoja për blerjen e mallrave, materialeve dhe shërbimeve.

Për grup mallrat e ngjashme në blerjet me vlera të vogla është tejkaluar limiti ligjor prej 400,000 lekë për vitin 2014 dhe 800,000 lekë për vitin 2015. Për pasojë Albpetrol SHA duhet të bëjë programime të qartë dhe të sakta të nevojave vjetore për blerjen e materialeve dhe bazuar në këto nevoja të zhvillojë procedurat përkatëse të prokurimit, sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (trajtuar më hollësisht në faqet 71-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që procedurat e prokurimit “Blerje me vlera të vogla”, të bëhen të argumentuara dhe sipas nevojave reale të shoqërisë, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Vazhdimisht

7. Mbi zbatimin e procedurave ligjore për dhënien me qira të ambienteve si dhe zbatimi i kushteve të kontratës.

Nga qendrat (njësitë vartëse) në administrim të Albpetrol SHA, nuk është proceduar me organet kompetente, për lirim dhe dorëzimin e ambienteve brenda afateve të njoftimit për lirim të urdhëruar prej tyre, në kundërshtim me shkresën nr. 612, datë 26.01.2015 të Albpetrol SHA, referuar dhe faktit se ky proces nuk është monitoruar për vazhdimësinë e tij dhe raportuar në organet drejtuese të shoqërisë nga Drejtoria e ARP dhe Drejtoria Juridike, në kundërshtim me detyrat funksionale të përcaktuara në rregulloren e brendshme (trajtuar më hollësisht në faqet 148-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

-Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekë dhe monitorojë në mënyrë të vazhdueshme të gjitha proceset, duke kërkuar nga institucionet kompetente marrjen e masave konform ligjit për lirim dhe kthimin e pronave në administrim të Albpetrol SHA. Për sa më sipër të raportohet vazhdimisht në organet drejtuese dhe administratori i shoqërisë.

Vazhdimisht

8. Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure të lidhura me kompanitë e huaja që operojnë në sektorin e kërkimit dhe nxjerrjes së naftës.

8.1. Gjatë zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure për zonat Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul, Ballsh-Hekal dhe vendburimi i Delvinës, të zonës Patos-Marinës, Visokës, Kuçovës, duke filluar nga viti 2011, kontraktorët kanë krijuar detyrime në likuidimin e sasisë së naftës pjesë e Albpetrol SHA, nga ndarja e prodhimit sipas marrëveshjeve hidrokarbure. Detyrimet janë krijuar në periudha kur çmimi i naftës brut ka qenë disa herë më i lartë se çmimi aktual.

Detyrimet kanë ardhur duke u akumuluar dhe si rrjedhojë e ndryshimit të Kontraktorit në marrëveshjen për zonat Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul, Ballsh-Hekal. Një pjesë e detyrimeve nuk garantohej për shlyerje. Vjelja e detyrimeve si më sipër përbën risk për Albpetrol SHA, i cili vjen si pasojë e mundësisë së dështimit të kontraktorëve për vazhdimësinë e të zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure. **Pavarësisht përpjekjeve të Albpetrol për vjeljen e detyrimeve, nuk janë bërë njoftimet për thyerje të marrëveshjeve dhe marrje të masave sipas tyre,** njoftime sipas të cilave kontraktorët do të vihehin nën presion në kohën e duhur për shlyerjen e detyrimeve, ose dorëzimin e zonave të shfrytëzimit sipas marrëveshjeve (trajtuar më hollësisht në faqet 114-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa për vjeljen e detyrimeve e krijuara nga kontraktorët për pjesën naftë brut dhe gaz, sipas marrëveshjeve. Në rast të mos shlyerjes dhe vazhdimit të akumulimit më tej të detyrimeve, të bëhen njoftimet sipas përcaktimeve në marrëveshjet hidrokarbure për thyerje të marrëveshjeve dhe të merren masat përkatëse sipas afateve që përcaktohet në to, me synim vjeljen e detyrimeve të cilat do të përmirësojnë treguesit ekonomiko-financiar të Shoqërisë.

Deri me datë 31.10.2015

8.2. Mbi zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure për zonat Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul, Ballsh-Hekal dhe vendburimi i Delvinës.

8.2.a. Për vitin 2014, për zonën Cakran-Mollaj, referuar programimit, prodhimi është zvogëluar në masën 25 % nga parashikimi, për zonën Ballsh-Hekal është zvogëluar në masën 50 % dhe për zonën Gorisht-Kocul është rritur në masën 50 %. Për vitin 2015, edhe në zonën Gorisht-Kocul, prodhimi ka ardhur në rënie. Ky rezultat vjen nga zvogëlimi i investimeve në operacionet hidrokarbure, megjithëse ato nuk raportohen me vlerë të vogël, sepse koeficienti R, është në nivelin më të vogël se 1. Ndërkohë që kontraktori nuk zbaton investimet e planifikuara, shpenzime fiktive përfshihen në kostot hidrokarbure, për më tej nuk likuidon as pjesën e Albpetrol që vjen nga ndarja e prodhimit. Nga auditimi rezultoi se, marrëveshja hidrokarbure është e tipit marrëveshje me ndarje prodhimi (Production Sharing Agreements), sipas të cilës në fazën e zhvillimit kompanisë i lejohet të përdorë të ardhurat nga nafta për të rikuperuar kostot e operacioneve hidrokarbure të fazës së kërkimit dhe të fazës së zhvillimit, të njohura si kosto të rikthyeshme (Cost Recovery). Ajo çfarë mbetet nga këto të ardhura është fitimi i cili ndahet sipas përqindjeve të përcaktuara midis kompanisë dhe shtetit. Në rastin kur këto të ardhura nga prodhimi dhe shitja e naftës janë më të vogla se kostot e njohura të rikuperueshme, atëherë Faktori R konsiderohet $R \leq 1$, në rast të kundërt Faktori R konsiderohet $R \geq 1$. Përqindjet që i përkasin kompanisë hidrokarbure dhe qeverisë shqiptare bazohen në ecurinë e faktorit R, i cili sipas marrëveshjes del si rezultat i raportit midis shpenzimeve totale dhe të ardhurave totale. Vetëm në rastet kur Faktori R ≥ 1 , pjesa e mbetur që konsiderohet fitim, ndahet sipas MH në 50 % për kompaninë hidrokarbure me 50% për qeverinë shqiptare.

Duke u gjendur përpara këtij fakti që $R \leq 1$, Qeveria shqiptare, nga viti 2008 e në vazhdim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat Kombëtare”, i ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin “Për hidrokarburet”, ka mundësuar implementimin e Rentës Minerare, ku kompanitë e hidrokarbureve në zhvillim paguajnë 10 % të shitjeve brenda dhe jashtë vendit në favor të buxhetit të shtetit. Duhet të theksojmë se vlera që arkëtohet në buxhetin e shtetit është njëkohësisht e njohur për kompaninë si Cost Recovery, që do të thotë këtë vlerë të konvertuar në sasi naftë e ka pronë të saj kompania. Në dukje krijohet përshtypja që shteti përfiton nga Renta Minerare, por në fakt në raste të tilla kjo ka ndikuar ndër vite, në mos arritjen e Faktorit $R \geq 1$, gjë që do të sillte të ardhura të tjera shumë më të larta për shtetin shqiptar e të pa ngarkuar me Cost Recovery.

Kontraktori ka bërë përpjekje për shmangien e detyrimeve duke transferuar interesat (shitur aksionet) tek një kompani tjetër. AKBN ka miratuar këtë veprim edhe pse sipas marrëveshjes kjo kompetencë është e Albpetrol SHA. Albpetrol ka nënshkruar një marrëveshje për shlyerjen

me kompensim të detyrimeve, në të cilën nuk ka përfshirë të gjitha detyrimet, duke vënë në rrezik vjeljen e tyre. **Vlera e këtyre detyrimeve përben dëm ekonomik**, përderisa nuk janë përfshirë në marrëveshje. Pas konstatimit nga grupi i auditimit, në muajin shtator Albpetrol SHA ka paraqitur një dokument sipas të cilit Kompania merr përsipër shlyerjen e të gjitha detyrimeve. Në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet Albpetrol SHA dhe “Për shuarjen, me kompensim të detyrimeve të ndërsjellta ndërmjet Albpetrol SHA,, MF dhe MZHETTS”, marrëveshje e cila nuk ka marrë miratim përfundimtar, duhet të përfshihet detyrimi i plotë si dhe penalteti në progresivitet për mos zbatimin e marrëveshjes së datës 28.02.2014, marrëveshje e cila përcaktonte shlyerjen e në vlerë të detyrimeve të krijuara deri në fund të vitit 2013 (trajtuar më hollësisht në faqet 114-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa dhe t’i kërkojë Kontraktorit, zbatimin me korrektësi të marrëveshjeve hidrokarbure sa i përket zbatimit të programeve vjetore, si dhe rritjen e kontrollit e monitorimit të zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure, të cilat rezultojnë vazhdimisht me rritje të shpenzimeve dhe ulje të të ardhurave, me synim rritjen e efektivitetit të zbatimit të tyre, e cila shoqërohet me rritje të përfitimeve për shtetin.

Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Albpetrol SHA dhe Kontraktorit, duhet të përfshijë të gjitha detyrimet që Kompania ka ndaj Albpetrol, duke përllogaritur edhe progresivitetin e penaltetit për mos zbatimin e marrëveshjes së datës 28.02.2014, ndërmjet Albpetrol SHA dhe Kompanisë

Deri me datë 31.10.2015

8.2.b. Për zonën Cakraj-Mollaj, koeficienti R ka ardhur në rritje deri në vitin 2014. Për zonën Ballsh-Hekal, koeficienti R deri në vitin 2010 ka ardhur në rritje, pastaj në zbritje. Për zonën Gorisht-Kocul koeficienti R ka ardhur në rritje duke e kaluar njësinë 1 për vitin 2012 dhe 2013, sipas të cilit do të mundësohej ndarja e fitimit me Qeverinë Shqiptare në masën 50 %. Ky fitim nuk është derdhur në momentin e krijimit dhe Kontraktori abuzivisht ka paraqitur shpenzime të larta për periudhën në vijim duke e shmangur këtë detyrim, sepse në vijimësi ka paraqitur shpenzime të larta duke e përmbysur përsëri koeficientin R, i cili në periudhën aktuale është më i vogël se 1. Në këtë periudhë Albpetrol SHA duhet të merrte masat duke njoftuar organet kompetente për realizimin pagesës në masën 50 % mbi fitimin. Duke qenë se Kontraktori nuk ka likuiduar detyrimin për fitimin në këtë periudhë, ka shfrytëzuar përcaktimet e marrëveshjes sipas të cilës Koeficienti R përllogaritet në progresivitet referuar fillimit të saj dhe në periudhën aktuale rezulton më i vogël se 1, sipas të cilit duke qenë se shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat nuk përbën ndarje fitimi. Ky veprim shpreh qartë abuzimin e kësaj kompanie në zhvillimin e opracioneve hidrokarbure, për të cilat Albpetrol SHA duhet të marrë masa konkrete, si nga ana e saj, ashtu dhe në ngritjen e kësaj problematike në AKBN dhe Ministrinë e linjës.

Pavarësisht se për vitin 2014 dhe deri në qershor 2015 koeficienti R është më i vogël se 1, Albpetrol SHA duhet të llogarisë pjesën fitim që Kontraktori duhet të likuidonte për vitin 2012 dhe 2013 dhe të kërkojë likuidimin e tij. Në përllogaritjen e kësaj vlere duhet të merren në konsideratë edhe zbritjet e kostos së operacioneve hidrokarbure, të cilat nuk i janë njohur Kontraktorit, nga ana e Albpetrol (trajtuar më hollësisht në faqet 117-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të analizojë, të marrë masat e duhura për llogaritjen e vlerës së të ardhurave të kontraktorit mbi vlerën e shpenzimeve për vitin 2012 dhe 2013, për zonën Gorisht-Kocul duke njoftuar organet përkatëse shtetërore, për vlerën e detyrimit të ndarjes së fitimit, detyrim i cili duhet të likuidohej gjatë viteve 2012 dhe 2013. Ky detyrim duhet të sanksionohet edhe në

amendimin e marrëveshjes “Për shuarjen, me kompensim të detyrimeve të ndërsjellta ndërmjet Albpetrol SHA,, MF dhe MZHETTS”

Albpetrol SHA të auditojë llogaritë e Kontraktorit të paraqitura si kosto hidrokarbure, për nxjerrjen e shkaqeve sipas të cilave koeficienti R i cili ishte më i madh se 1 në vitin 2012 dhe 2013 ndërsa në periudhën aktuale rezulton më i vogël se 1, duke marrë masat përkatëse, me synim arritjen e përfitimeve nga ndarja e fitimit mes Kontraktorit dhe Qeverisë Shqiptare.

Deri me datë 31.10.2015

8.2.c. Nga ana e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, në periudhën janar-tetor 2014, është kryer një auditim në lidhje me koston e operacioneve hidrokarbure të marrëveshjeve hidrokarbure për zonat Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul, Ballsh-Hekal dhe vendburimi i Delvinës, për periudhën tetor-dhjetor 2012 dhe janar-tetor 2013.

Auditimi ka rezultuar me parregullsi në lidhje me paraqitjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure, me vlerë **4,219,205,558 lekë, ose 33,222,091 USD**. Albpetrol është mjaftuar vetëm me konstatimet e auditit, pa marrë hapat e mëtejshëm, siç është mos pranimi i raporteve, pa zbritur vlerën e mësipërme të përfshirë nga Kontraktori si shpenzime në operacionet hidrokarbure. Nga sa më sipër rezulton se Kontraktori ka përfshirë një sërë shërbimesh si kosto hidrokarbure pa paraqitur asnjë dokumentacion për justifikimin e realizimit të tyre. Ky fakt tregon shmangie të theksuara nga përcaktimet e marrëveshjeve hidrokarbure nga ana e Kontraktorit si dhe punë aspak efikase të strukturave të Albpetrol në monitorimin hap pas hapi të zbatimit të këtyre marrëveshjeve.

Albpetrol duhet të ndjekë me rigorozitet zbatimin e programeve vjetore si dhe inspektime të vazhdueshme gjatë zbatimit të marrëveshjeve, në mënyrë që veprimet e mundshme abuzive të kontraktorëve të reflektohen që në momentin e paraqitjes së raporteve mujore apo 3 mujore, për mundësimin e rritjes së përfitimeve nga zbatimi i marrëveshjeve, fitim i cili mund të arrihet shumë shpejt pas zbritjes së vlerës së mësipërme, zbritja e të cilës përmirëson koeficientin R, i cili i afrohet vlerës 1, kryesisht për zonën Gorisht-Kocul (trajtuar më hollësisht në faqet 116-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masat përkatëse për reduktimin e vlerës së shpenzimeve të kostove hidrokarbure me vlerë 4,219,205,558 lekë, ose 33,222,091 USD, si shpenzime të pajustificuara nga Kontraktori, mbartës i interesave të Kompanisë Të bëhet rillogaritja e koeficientit R, i cili edhe pas zbritjes së vlerës së mësipërme rezulton më i vogël se 1 dhe të bëhen kontrole, inspektime, monitorime dhe auditime të vazhdueshme të llogarisë kosto hidrokarbure të Kontraktorit, me synim arritjen e koeficientit R mbi 1, i cili shoqërohet me ndarje të fitimit ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Kontraktorit.

Deri me datë 30.11.2015

8.3 Mbi zbatimin e marrëveshjes hidrokarbure me Kompaninë

8.3.a. Gjatë zbatimit të marrëveshjes hidrokarbure për zonën Patos-Marinës, shpenzimet raportohen në nivel më të lartë se sa të ardhurat. Sasitë e naftës brut që përfiton Albpetrol, kanë ardhur në rënie për arsye se pusët e vjetra të cilët vihen në dispozicion të kontraktorit për shfrytëzim kanë ardhur në zvogëlim ndërsa pusët e reja të cilat hapen nga Kontraktori kanë ardhur në rritje. Në stadin aktual, Albpetrol përfiton vetëm 5.8 % të prodhimit, i cili pas disa vitesh (me daljen nga funksioni të puseve të vjetra) do të shkojë më pak se 2 % (trajtuar më hollësisht në faqet 129-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa dhe të kërkojë nga Kontraktori respektimin e marrëveshjes hidrokarbure, zbatimin me korrektësi të programeve vjetore të operacioneve hidrokarbure dhe realizimin me efektivitet të investimeve, me synim rritjen e prodhimit dhe uljen e kostove hidrokarbure.

Gjatë zbatimit të marrëveshjes hidrokarbure

8.3.b. Gjatë zbatimit të marrëveshjes hidrokarbure për zonën Patos-Marinëz, nga ana e Kontraktorit përdoren teknologji të papranueshme, si pasojë e të cilave shtresat nëntokësore po dëmtohen dhe do të vazhdojnë të dëmtohen, duke krijuar humbje të mëdha për Albpetrol në terma afatgjatë. Megjithatë në marrëveshje përcaktohet se gjatë operacioneve hidrokarbure, kontraktorët duhet të përdorin metoda dhe teknologji të pranueshme ndërkombëtarisht, nga ana e Albpetrol nuk janë marrë masa për ndalimin e tyre (trajtuar më hollësisht në faqet 134-136 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa dhe të analizojë përdorimin e teknologjive të papranueshme ndërkombëtarisht, efektet negative të përdorimit të tyre dhe të marrë masa për ndalimin e tyre, sipas përcaktimeve në marrëveshjen hidrokarbure.

Deri me 30.11.2015

8.3.c. Deri në momentin e hartimit të këtij materiali, për marrëveshjen e hidrokarbure për zonën Patos-Marinëz, nuk është arritur faktori $R \geq 1$. Nga viti 2009-2014, Faktori R ka variuar nga 0.7178 në 0.9638 për vitin 2014. Duke u gjendur përpara këtij fakti që $R \leq 1$, Qeveria shqiptare, nga viti 2008 e në vazhdim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat Kombëtare”, i ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin “Për hidrokarburet”, ka mundësuar implementimin e Rentës Minerare, ku kompanitë e hidrokarbureve në zhvillim paguajnë 10 % të shitjeve brenda dhe jashtë vendit në favor të buxhetit të shtetit. Vlera që arkëtohet në buxhetin e shtetit është njëkohësisht e njohur për kompaninë si Cost Recovery, që do të thotë këtë vlerë të konvertuar në sasi naftë e ka pronë të saj kompania. Në dukje krijohet përshtypja që shteti përfiton nga Renta Minerare, por në fakt në raste të tilla kjo ka ndikuar ndër vite, në mos arritjen e Faktorit $R \geq 1$, gjë do të sillte të ardhura të tjera shumë më të larta për shtetin shqiptar e të pa ngarkuar me Cost Recovery.

Duke qenë se, në vazhdimësi koeficienti R rezulton më i vogël se 1, si pasojë e të cilit nuk krijohen kushte për të përfituar nga qeveria shqiptare, përveç sa u trajtua më sipër, shfrytëzimi i këtyre burimeve naftëmbajtëse për një përfitim të papërfillshëm do të sjellë pasojë për këtë sektor në të ardhmen, duke marrë edhe në konsideratë faktin se këto burime nuk janë të pasqyrtueshme (trajtuar më hollësisht në faqet 133-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa për realizimin e një studimi mbi sasi të naftës brut të disponueshme në zonën e marrëveshjes dhe paraqitjen e termave për shfrytëzimin sa më optimal të tyre. Të rritet monitorimi dhe inspektimet përgjatë kohës së realizimit të operacioneve hidrokarbure, duke bërë orientimet për ndërhyrje dhe hapje të puseve të reja sipas përcaktimeve në marrëveshjen hidrokarbure.

Nga ana e MEI dhe AKBN, të merren masa për të vendosur instrumente monitorimi të efektshme dhe të kërkojë rivlerësimin objektiv të planeve të zhvillimit, operacioneve teknike dhe të marrë masa për rritjen e profesionalizimit në realizimin e auditimeve financiare lidhur me kostot që përfshihen në aktivitetin hidrokarbur, për t'i vënë në efikasitet marrëveshjet e lidhura, me qëllim të një vlerësimi të saktë të Faktorit R, me synim mos shmangien e detyrimeve financiare ndaj shtetit. Në çdo rast të përcaktohet niveli i përgjegjësisë së individëve të përfshirë në këtë proces në mënyrë që t'i pritët rruga informalitetit të këtyre monitorimeve ku interesat e shtetit shihen të fundit.

Deri me 31.12.2015

8.3.d. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, raporti të ardhura shpenzime (koeficienti R), nuk pritët të bëhet mbi 1 deri në vitin 2022. Ky parashikim përbën një devijim të madh nga parashikimet e marrëveshjes.

Gjatë auditimit ka rezultuar se Plani Zhvillimit Afatgjatë, i cili nuk është bërë për përmirësimin e marrëveshjes hidrokarbure në raport me pozitën e shtetit shqiptar, nuk kanë ndikuar në arritjen e Faktorit $R \geq 1$, por në të kundërt. Këto ndryshime janë miratuar ndër vite nga të gjitha strukturat e shtetit në nivel qendror. Si pasojë e ndryshimeve të Planeve të Zhvillimit kohë

mbas kohe, treguesit ekonomiko-financiar të arritur nga veprimtaritë e kompanive hidrokarbure kanë pasur mospërputhje, krahasuar me parashikimet e miratuara në Planet Afatgjatë të Zhvillimit (PZH), Planet dhe Buxhetet e Punës vjetore (PP&B), duke raportuar të kryera me tejkalim shpenzimet, krahasuar me naftën e nxjerrë, pavarësisht se me rritje, duke iu përafëruar Faktori $R=1$, por duke mos e arritur asnjëherë. Me qëllim që Faktori R të jetë real, kërkohet që dhe shpenzimet e rikuperueshme të jenë reale, gjë e cila kërkon dhe sigurohet nga një auditim kompetent profesional, me integritet, në kohë si dhe një monitorim perfekt i të gjitha proceseve hidrokarbure që zhvillohen nga kompanitë e që njihen si Costo Recovery.

Albpetrol duhet të analizojë shkaqet dhe të ndjekë në vazhdimësi shpenzimet e përfshira nga Kontraktori si kosto hidrokarbure, veprim i cili do të bënte që raporti të ardhura shpenzime të përmirësohet, duke arritur përfitime për shtetin, jo vetëm nga ndarja e prodhimit, por edhe nga ndarja e fitimit të realizuar (trajtuar më hollësisht në faqet 133-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol të ndjekë dhe monitorojë zbatimin e marrëveshjes hidrokarbure për zonën Patos-Marinëz, por edhe për zona të tjera. Për devijime nga parashikimet në marrëveshje hidrokarbure, të bëhen njoftimet përkatëse sipas marrëveshjes, duke lënë kohën e nevojshme për përmirësimin e situatës, në të kundërt kërkimin e dorëzimit të fushave në shfrytëzim dhe ndërprerjen e marrëveshjes, me synim përmirësimin e efektivitetit të operacioneve hidrokarbure dhe arritjen e koeficientit R mbi 1, veprim i cili do të shoqërohej me marrjen e përfitimit ndërmjet Kontraktorit dhe Qeverisë Shqiptare.

Deri me datë 31.10.2015

8.3.e. Gjatë zbatimit të marrëveshjes, Kontraktori ka investuar për shpime pusesh të reja, vetëm në 20 %, të zonës së marrë për shfrytëzim sipas marrëveshjes. Kjo vjen si shkak i përqindjes së lartë të shtresave të kësaj zone. Kontraktori synon të shfrytëzojë shtresat me përmbajtje më të lartë naftë brut, duke vënë në dyshim shfrytëzimin e shtresave të tjera përgjatë periudhës së kontratës. Duke qenë se, koeficienti R është në nivelin me të vogël se 1, ndërkohë që shfrytëzohen shtresat e pasura, në vazhdimësi, kostoja e operacioneve hidrokarbure në krahasim me prodhimin do të vijë në rritje, duke ndikuar më tej në uljen e koeficientit R , pra duke rrezikuar përfitimet e mundshme nga kjo kontratë (trajtuar më hollësisht në faqet 133-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa dhe të kërkojë nga Kontraktori që në planin e shfrytëzimit të zonës sipas marrëveshjes, të përfshihet shfrytëzimi i gjithë zonës, jo vetëm në një sektor të saj, me synim zhvillimin e të gjithë zonës së përcaktuar në marrëveshje dhe rritjen e përfitimeve nga shfrytëzimi i shtresave naftë mbajtëse.

Deri me datë 31.10.2015

8.3.f. Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure ka realizuar auditimin për periudhën e realizimit të operacioneve hidrokarbure shtator 2012-shtator 2013. Nga ky auditim janë konstatuar përfshirje të punimeve dhe shërbimeve në kostot e operacioneve hidrokarbure, në kundërshtim me marrëveshjen dhe pa i mbështetur me dokumentacionin ligjor justifikues të realizimit të tyre. Për këto shpenzime Albpetrol SHA ka njoftuar kontraktorin për zbritjen e tyre, por kjo zbritje nuk është reflektuar deri në momentin e hartimit të këtij materiali. Rezultatet e auditimit janë evaduar me vonesë, si dhe i është miratuar kontraktorit shtesë në afatin e paraqitjes së observacioneve, pa ndonjë arsye të përligjur. Ky proces si pasojë i të cilit Qeveria Shqiptare përfiton vlera të konsiderueshme, nuk është vlerësuar siç duhet nga Albpetrol SHA. Krahas njoftimit për zbritje të shpenzimeve nga kostot hidrokarbure, Albpetrol SHA duhet të përllogariste vlerën e koeficientit R i cili pas zbritjes së kostove të pa njohura, kalon vlerën 1, i cili shoqërohet me fitim për Qeverinë Shqiptare, nga ndarje e fitimit në masën 50 %. Njoftimi për mos njohjen e këtyre kostove të përfshira në kostot hidrokarbure, duhet të shoqërohej edhe

me njoftimin për devijim material, aktivitet në keqbesim, i cili konsiderohet si thyerje e marrëveshjes (trajtuar më hollësisht në faqet 134-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa për realizimin e auditimeve për të gjithë shpenzimet e përshkruara nga Kontraktorët si kosto e operacioneve hidrokarbure. Po ashtu, të merren masa për realizimin e inspektimeve të vazhdueshme si gjatë zbatimit të operacioneve hidrokarbure duke krahasuar të dhënat e tyre me dokumentacionin që kontraktori paraqet për justifikimin e shpenzimeve, në mënyrë që të mos krijohen mundësitë që kontraktorët të paraqesin të dhëna fiktive për rritjen artificiale të koston e operacioneve hidrokarbure, kosto të cilat kanë ndikim direkt në mbajtjen e koeficientit R me vlerë nën 1 dhe rrjedhimisht mos ndarje të fitimit me Qeverinë Shqiptare.

Vazhdimisht

8.3.g. Gjatë muajit mars 2015, është zhvilluar një ankand për shitjen e sasisë 100,000 ton naftë brut. Sasia e mësipërme përfshin edhe sasinë 13,656 ton naftë brut, nga Kompania Rezulton se me kontraktorët nuk janë bërë negociata për kompensim në vlerë për sasi të naftës brut detyrim, por janë përfshirë në shitje nëpërmjet ankandit, në kundërshtim me VKM nr. 947, datë 29.12.2014, Pika 3, vendim i cili përcakton çmimin e naftës brut bazuar në çmimin e shitjes së kontraktit në periudhën përkatëse. Përfshirja e këtyre sasive në ankand, bën që përfitimi i Albpetrol të jetë shumë më i vogël, sepse çmimi i naftës brut në periudhën aktuale është shumë më i vogël se çmimi referuar periudhës së lindjes së detyrimit. Për këtë duhet të përcaktohet që kjo sasi do të merret nga sasia detyrim e vitit aktual, për të shmangur humbjet si pasojë e rënies së çmimit të naftës në bursë (trajtuar më hollësisht në faqet 135-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa që, sasia e naftës brut në sasinë 13,656 ton e përfshirë në ankand nga detyrimet që Kompania ka ndaj Albpetrol SHA, të përcaktohet nga sasia detyrim i vitit 2015 dhe jo si pjesë e detyrimit të krijuar, sepse çmimi aktual i naftës brut është shumë më i vogël krahasuar me çmimin e naftës brut në momentin e krijimit të detyrimit. Në të kundërt, të kërkohet nga Kontraktori zhdëmtimi i vlerës 4,079,047.2 USD, e cila vjen nga diferenca e çmimit të shitur në ankandin e muajit mars 2015 të realizuar nga Albpetrol, me çmimin e shitjes së ponderuar të naftës brut nga Kontraktori në vitin 2013.

Deri me datë 31.10.2015

8.3.h. Për vlerësimin e përmbytjeve në zonën e Marinzës, Albpetrol ka analizuar ngjarjen duke dhënë edhe argumente teknike, sipas të cilave fontana është shkaktuar për mangësi të kontraktit gjatë zbatimit të operacioneve hidrokarbure. Pavarësisht kësaj analize, nga kontraktori është pretenduar se kjo ngjarje duhet të trajtohet si forcë madhore. Përmbytjet e shkaktuara në këtë zonë kanë të bëjnë me përdorimin e teknologjive të ndaluara në këtë fushë, si dhe për faktin e mos sigurimit të kushteve teknike, gjatë zbatimit të operacioneve hidrokarbure. Këto raste janë përcaktuar qartë në nenin 20, pika 3 të marrëveshjes hidrokarbure, ku përcaktohet se, shpenzimet për rehabilitimin e zonës dhe shpërblimin e dëmeve duhet të bëhen nga Kontraktori dhe nuk duhet të përfshihen në koston e operacioneve hidrokarbure. Albpetrol megjithëse është e ngarkuar ligjërisht për ndjekjen e zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure, nuk ka marrë masat e duhura si dhe nuk ka informacion të saktë mbi realizimin e rehabilitimit dhe masën e zhdëmtimit të pasurisë së banorëve të zonës (trajtuar më hollësisht në faqet 140-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa dhe t'i kërkojë Kontraktorit zhdëmtimin e të gjitha dëmeve të shkaktuara si pasojë e shpërthimeve në Marinzës, si për pasurinë e banorëve të zonës, ashtu edhe nga ana teknike, duke rikthyer në gjendjen e mëparshme zonën e dëmtuar. Kosto e këtij procesi nuk duhet të përfshihet në koston e operacioneve hidrokarbure të Kompanisë, sipas Nenit 20, Pika 3, të marrëveshjes-hidrokarbure.

Bazuar në referencat e mësipërme, Albpetrol SHA të marrë masa për shqyrtimin dhe zgjidhjen e të gjitha ankesave të banorëve të zonës, si për zhdëmtimet ashtu dhe për rehabilitimin e mjedisit.

Nisur nga ankesat që banorët e zonës Marinëz kanë depozituar në KLSH, në të ardhmen KLSH do iniciojë një auditim tematik për këtë çështje.

Deri me datë 31.10.2015

8.3.i. Nga auditimi i marrëveshjes për zonën Patos-Marinëz, rezultoi se në vitin 2008 Kontraktori ka marrë nga Raiffeisen Bank një kredi prej 30 milion USD, për të financuar Planin e Zhvillimit. Gjatë vitit 2013 kompania ka vazhduar punën për të zbatuar “Plan Veprimi Social Mjedisor” siç është rënë dakord me IFC dhe BERZH, në të cilin pasqyrohen drejtimit kryesore të punës që priten të arrihen gjatë Programit Vjetor të vitit 2015, për rehabilitimin dhe përmirësimin e tokës nëpërmjet ngritjes së impiantit të përpunimit të llumrave, menaxhimit të mbetjeve si dhe monitorimit të ndikimit në mjedis. Rehabilitimi i mjedisit parashikon ndërtimin dhe trajtimin e Gropave Ekologjike 1&2, përpunimin e dherave dhe llumrave të ndotur që krijohen nga prodhimi, pastrimi e rehabilitimi i puseve e shesheve ku kryhen operacione dhe rehabilitimi i dherave të ndotur në rreth 200 sheshe të ndotura. Për të mundësuar këto hua, Kontraktori, ka transferuar interesat e Marrëveshjes Hidrokarbure tek këto banka, në kundërshtim të plotë si me Marrëveshjen Hidrokarbure dhe bazën ligjore që operon në fushën hidrokarbure. Nga ana e Albpetrol SHA nuk disponohet informacioni i saktë për sasinë e aseteve të përdorura për kolateral, të cilat janë të përfshira në kostot e operacioneve hidrokarbure, megjithëse për këtë qëllim i ka kërkuar Kontraktorit informacion të detajuar (trajtuar më hollësisht në faqet 141-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë nga Kontraktori, ashtu dhe nga kontraktorët e tjerë të cilët zbatojnë marrëveshje hidrokarbure, informacion të detajuar mbi asetet e përfshira si vlerë në kostot hidrokarbure të cilat mund të jenë përdorur si kolateral për kreditim, me synim parandalimin e humbjeve në raste të tërheqjes së mundshme të Kontraktorëve nga marrëveshjet hidrokarbure. Albpetrol duhet të marrë vendime konformë përcaktimeve në marrëveshjet hidrokarbure, duke zbritur vlerën e këtyre aseteve e cila është përfshirë në koston e operacioneve hidrokarbure, si dhe të rillogarisë vlerën e koeficientit R i cili duhet të rezultojë më i lartë, si pasojë e zvogëlimit të vlerës së koston hidrokarbure.

Deri me datë 31.10.2015

8.4 Mbi zbatimin e marrëveshjes hidrokarbure me Kompaninë Për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në vendburimin Visokë.

Zbatimi i marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Visokë është shoqëruar me prodhim më të vogël nga parashikimi. Shpenzimet për investime janë më pak nga parashikimi, si rezultat i të cilit kemi edhe një prodhim më të vogël nga parashikimi (trajtuar më hollësisht në faqet 144-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë nga Kontraktori mbartës i interesave të Kompanisë, të paraqesë plane zhvillimi dhe ti realizojë ato, sipas përcaktimeve në marrëveshjen hidrokarbure, në të kundërt, të bëhen njoftimet përkatëse për devijim material, duke marrë vendimet përkatëse konformë përcaktimeve në marrëveshje.

Deri me datë 31.10.2015

8.5. Kompania, Për “Zhvillimin dhe prodhimin e naftës në vendburimin Kuçovë”.

8.5.a. Kontraktori ka bërë studimin e zonës dhe ka mbledhur informacionin e nevojshëm, por nuk ka kryer operacione të mirëfillta hidrokarbure. Gjithashtu, kontraktori ka kërkuar zgjatjen e Periudhës së Vlerësimit edhe me 12 muaj të tjerë, mbi 24 muajt që duhet të zgjasë ajo.

Kontraktori ka kërkuar ndryshimin e teknologjisë që do të zbatohet, në ndryshim nga ajo e miratuar në marrëveshje, nga përdorimi i pompave me burmë, me injektim të ujit, si metoda më e përshtatshme për zhvillimin dhe prodhimin e naftës në vendburimin e Kuçovës.

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se, Kontraktori ka realizuar prodhim më të vogël nga parashikimi edhe pse ka raportuar rritje të shpenzimeve dhe investimeve krahasuar me programin (trajtuar më hollësisht në faqet 145-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë nga kontraktori përdorimin e teknologjive të pranuar ndërkombëtarisht sipas përcaktimeve në marrëveshjen hidrokarbure. T'i kërkohet kontraktorit angazhimi për zhvillimin e operacioneve hidrokarbure dhe përmirësimi i treguesve sipas përcaktimeve të marrëveshjes, në të kundërt, të bëhet njoftimi për devijim material duke marrë vendimet përkatëse konformë përcaktimeve në marrëveshje.

Deri me datë 31.10.2015

8.5.b. Drejtoria e Hidrokarbureve pranë Albpetrol, në zbatim të programit të auditimit nr. 5455, datë 30.12.2013, ka audituar shpenzimet e operacioneve hidrokarbure për tre mujorin e katërt 2012 dhe periudhën janar-shtator 2014. Rezultatet e këtij auditimi i janë përcjellë Kompanisë, me shkresë nr. 5455/1, datë 26.12.2014. Kompanisë i është bërë e ditur mos njohja si shpenzime pjesa e kostos së operacioneve hidrokarbure, me vlerë 2,886,000 USD. Për këtë vlerë, auditit të Albpetrol nuk është vënë në dispozicion dokumentacioni që justifikon shpenzimet. Krahas kërkesës për zbritjen e vlerës së mësipërme nga kosto e operacioneve hidrokarbure, Albpetrol SHA duhet të merrte masat e parashikuara në marrëveshje për konsiderimin e mos paraqitjes së dokumentacionit si thyerje të marrëveshjes (trajtuar më hollësisht në faqet 146-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa për zbritjen e vlerës 2,886,000 USD nga kostoja e operacioneve hidrokarbure, si shpenzime të pajustificuara nga ana e Kontraktorit. Në auditimet pasuese, mos paraqitja e dokumentacionit nga Kontraktori duhet të konsiderohet si thyerje e marrëveshjes.

Deri me datë 30.11.2015

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Mbi organizimi dhe mbajtjen e evidencave kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi e miratimi i tij në organet e vartësisë.

Nga Albpetrol SHA, gjatë vitit 2014 dhe 2015, është miratuar dhënia e sponsorizimeve, ku një pjesë e përfituesve kanë tërhequr fondet paradhënie, por nuk kanë paraqitur asnjë dokument justifikues të shpenzimit, megjithëse ka përfunduar afati i përcaktuar në kontratë për realizimin e projektit të sponsorizuar, ose kur ky afat ka qenë i papërcaktuar, ka kaluar koha e efektivitetit dhe qëllimit të sponsorizimit (trajtuar më hollësisht në faqet 55-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Të kontabilizohen dhe ndiqen të gjitha rrugët ligjore, për arkëtimin e shumave të rezultuara të pa dokumentuara dhe justifikuara, pas verifikimit me subjektet përfituese të sponsorizimit për projektet në zhvillim dhe ku referuar gjendjes deri më 30.07.2015 paraqiten me këto detyrime:

a. në shumën 840,000 lekë paradhënie, ku megjithëse e ka lidhur kontratën pa afat, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në lidhje me realizimin e serialit televiziv me 6 seri për historikun e naftës në Shqipëri, megjithëse kontrata është lidhur më datën 8.09.2014.

b. Bashkia Fier, në shumën 1,026,342 lekë paradhënie për bustin e Projekti nuk është realizuar akoma. Nuk ka të paraqitura dokumente që projekti është në zhvillim. Duke qenë se afati kontraktor ka përfunduar, nëse realizimi i këtij busti është në proces, të bëhen shtyrjet e nevojshme në afatin kohor kontraktor, për realizimin e tij sipas parashikimeve.

c. (ekspozitë fotografike) në shumën 20,000 lekë dhënë më tepër si rezultat i llogaritjeve me gabime të shpenzimeve krahasuar këto dhe me preventivin e paraqitur.

Deri me datë 30.11.2015

2. Mbi auditimin e gjendjes së debitorëve dhe kreditorëve, si dhe zbatimin e ligjshmërisë për inventarizimin e pasurisë.

Nga Albpetrol SHA janë transferuar fonde në formën e huas, në kundërshtim me ligjet në fuqi, por në zbatim të urdhrit të ministrit të MZHETTS nr. 545, datë 12.12.2014 për 7 shoqëri me kapital shtetëror në shumën 60,874,216 lekë me kushte kthimi sipas kontratës për 6 shoqëri brenda 1 muaji dhe për 1 shoqëri deri në fund të vitit 2015. Nga auditimi është konstatuar se nuk është kthyer huaja sipas kushteve të kontratës nga 4 shoqëri aksionare (trajtuar më hollësisht në faqet 58-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

-Nisjen e procedurave gjyqësore nga Albpetrol SHA, në zbatim të kontratave të lidhura, për rimarrjen e shumave të pa arkëtuara nga :

a- në shumën 3,457,290 lekë

b- në shumën 2,089,211 lekë shumë e pa arkëtuar.

c- 2,754,668 lekë.

d- në shumën 4,901,571 lekë.

e- Skedulimin e arkëtimit të detyrimit prej 40,000,000 lekë të deri më 31.12.2015, konform afatit të përcaktuar në kontratë.

Menjëherë

3. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në veprimet e arkës dhe bankës në lekë e valutë, si dhe blerjet me vlera të vogla.

3.1. Janë kryer pagesa me arkë në lekë për urdhër shërbime brenda vendit pa dokumentacion justifikues, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, **në vlerën totale 133,160 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 68-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masat në rrugë ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, gjithsej në shumën 133,160 lekë, nga z. me detyrë Administrator i shoqërisë dhe znj. me detyrë Kryespecialiste Finance, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

Deri me datë 31.10.2015

3.2. Nga veprimet me arkë në valutë janë kryer pagesa për urdhër shërbime jashtë vendit pa dokumentacion justifikues, në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011, pika 11 ku thuhet “...shpenzimet e transportit, të fjetjes dhe pagesat e tjera, në të gjitha rastet, njihen dhe paguhen sipas dokumentit përkatës justifikues (faturë, bileta etj.), **në vlerën totale 345,800 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 69-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa në rrugë ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, gjithsej në shumën 345,800 lekë, nga z. me detyrë Administrator i shoqërisë dhe znj. me detyrë Kryespecialiste Finance, në kundërshtim me VKM nr. 870, datë

14.12.2011, pika 11 ku thuhet "...shpenzimet e transportit, të fjetjes dhe pagesat e tjera, ne te gjitha rastet, njihen dhe paguhen sipas dokumentit përkatës justifikues (faturë, bileta etj.).

Deri me datë 31.10.2015

3.3. Nga veprimet me bankë në lekë janë kryer pagesa të ndryshme, në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për QKR", neni 43/3 "Regjistrime të detyrueshme" dhe neni 74/3 "Kundërvajtjet administrative", në kundërshtim me kërkesën e nenit 19 pika 3 të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 dhe në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, në vlerën totale 383,000 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 69-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Financës, të marrin masat në rrugë ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën 383,000 lekë, konkretisht: vlerën 15,000 lekë nga z. dhe znj.; vlerën 160,000 nga z., z., z. dhe z.; vlerën 208,000 lekë nga z., përfituar në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.

Deri me datë 31.10.2015

4. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në fushën e prokurimeve, efektivitetin e investimeve, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

4.1. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Ndërtimi komplet i grupeve të grumbullimit të naftës nr. 7 dhe nr. 1 në v.b Ballsh" viti 2014, janë konstatuar diferenca të punimeve të realizuara krahasuar me situacionit e paraqitur. Vlera 695,522.4 lekë është shkelje e disiplinës financiare, me pasojë dëm ekonomik ndaj shoqërisë së Albpetrol SHA dhe duhet të zhdëmtohet nga shoqëria (trajtuar më hollësisht në faqet 83-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

-Të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës 695,522.4 lekë ndaj subjektit, si diferenca në zëra dhe volume në zbatimin e kontratës me objekt "Ndërtimi komplet i grupeve të grumbullimit të naftës nr. 7 dhe nr. 1, në vendburimin Ballsh".

Menjëherë

4.2. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje veshmbathje për punëtorët", me vlerë 16,351,200 lekë me tvsh, OE i shpallur fitues me kërkesën nr. 6591/9 prot, datë 22.12.2014, ka kërkuar zgjatjen e afatit të përfundimit të kontratës me 25-30 ditë, si pasojë e reshjeve dhe përmbytjeve në Turqi, ku gjendet dhe fabrika e prodhimit të këtyre pjesëve. Me amendimin nr. 6591/10, datë 26.12.2014, palët bien dakord për zgjatjen e afatit të kontratës deri më datë 25.01.2015. Nga verifikimi i dokumentacionit që OE ka paraqitur gjatë procedurës së prokurimit, emri i këtij prodhuesi (.....), nuk figuron në listën e prodhuesve të deklaruar, për të cilët ka marrë autorizim prodhuesi. Për pasojë, Autoriteti Kontraktor duhej të kishte llogaritur dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar, në zbatim të kontratës nr. 6591/5, datë 27.11.2014, në vlerën 1,765,930 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të shoqërisë Albpetrol SHA (trajtuar më hollësisht në faqet 111-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 1,765,930 lekë, nga operatori ekonomik, për dëmet e likuidueshme për vonesën në furnizimin e mallrave në zbatim të kontratës nr. 6591/5, datë 27.11.2014, të nënshkruar midis palëve.

Menjëherë

4.3. Në zbatimin e kontratës "Blerje pajisje laboratorike" rezulton se pajisjet sipas zërave 2, 6, 7 dhe 14, janë furnizuar në kundërshtim me dokumentet e tenderit dhe kontratën përkatëse, si për origjinën e pajisjeve, ashtu edhe sa i takon markës së tyre, të cilat nuk përputhen me

prodhuesin e paraqitur në dokumentet e tenderit. Vlera 4,626,450 lekë (3,855,375 lekë + TVSH) është përfituar padrejtësisht nga bashkimi i operatorëve ekonomikë & dhe përbën dëm ekonomik (trajtuar më hollësisht në faqet 76-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 4,626,450 lekë, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë dhe për furnizime të realizuara në kundërshtim me dokumentet e tenderit.

Menjëherë

5. Mbi zbatimin e procedurave ligjore për dhënien me qira të ambienteve si dhe zbatimi i kushteve të kontratës.

Nga qendrat (njësitë vartëse) në administrim të Albpetrol- sha, nuk është proceduar me organet kompetente, për lirim dhe dorëzimin e ambienteve brenda afateve të njoftimit për lirim të urdhëruar prej tyre, në kundërshtim me shkresën nr. 612, datë 26.01.2015 të Albpetrol SHA, referuar dhe faktit se ky proces nuk është monitoruar për vazhdimësinë e tij dhe raportuar në organet drejtuese të shoqërisë, në kundërshtim me detyrat funksionale të përcaktuara në rregulloren e brendshme (trajtuar më hollësisht në faqet 149-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

- Të kontabilizohet dhe të ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e shumës prej 87,000 lekë që përfaqëson periudhën midis dy kontratave të lidhura për ambiente të pasura në përdorim për 23 muaj x 3800 lekë qira mujore nga përfituesi dhe të pa arkëtuara nga Albpetrol -sha.

Deri me datë 31.10.2015

6. Zbatimi i procedurave të ankandit për shitjen e naftës brut, kontestës dhe gazit.

Në bilancin e naftës bruto për periudhën 01.07.2014-31.12.2014, QASHNG Patos ka zbritur firo transporti dhe magazinimi mbi normat e përcaktuara ligjore, sasinë prej 120.94 ton naftë bruto, me vlerë **2,253,595.96 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për llogari të Albpetrol SHA. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, i ndryshuar me VKM nr. 128, datë 20.02.2013, neni 34 “Normat e firove dhe humbjeve natyrale dhe teknike” (trajtuar më hollësisht në faqet 161-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 2,253,595.96 lekë, nga anëtarët e Këshillit Teknik:,,, dhe, për zbritjen nga bilanci i naftës bruto të periudhës 01.07.2014-31.12.2014, të sasisë 120.94 ton naftë, si firo transporti dhe magazinimi mbi normave e përcaktuara ligjore.

Deri me datë 31.10.2015

7. Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure të lidhura me kompanitë e huaja që operojnë në sektorin e kërkimit dhe nxjerrjes së naftës.

7.1 Marrëveshja me kompaninë

Pas dorëzimit të Procesverbalit nr. 1, datë 21.07.2014, grupit të auditimit i'u paraqit një marrëveshje e nënshkruar ndërmjet Albpatrol SHA dhe Kompanisë **“Për shuarjen, me kompensim të detyrimeve të ndërsjellta ndërmjet Albpetrol SHA,, MF dhe MZHETTS”**. Nga ana e Kontraktorit është likuiduar renta minerare me vlerë 10,169,253.51 USD. Krahas kësaj vlere në këtë marrëveshje është përcaktuar që 10 ditë pas

miratimit përfundimtar të saj,, do të shlyejë edhe detyrime me vlerë 7,424,724.89 USD, vlerë e cila nuk përfshin të gjitha detyrimet që ka ndaj Albpetrol SHA.

Në këtë marrëveshje nuk është përfshirë detyrimi i cili ka të bëjë me:

♦ Naftën brut gjendje në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes hidrokarbure në sasinë 10,216.5 ton me vlerë 2,708,291.9 USD (10,216.5 ton x 265.09 USD/ton), sipas çmimit të shitjes së naftës brut për periudhën e vitit 2015, në ankand.

♦ Penaliteti për mos zbatimin në kohë të marrëveshjes së datës 28.02.2014, për vonesë lëvrimit të sasive të naftës brut, ose kompensimin në vlerë, deri në momentin e auditimit, me vlerë 189,040.76 USD.

♦ Detyrimi që Kontraktori ka për shërbime ndaj Albpetrol në vlerë 1,500,000 USD.

♦ Vlera 747,409.25 USD (8,172,134.14-7,424,724.89), si diferencë nga përlllogaritjet e detyrimit me vlerën e njohur nga kontraktori sipas marrëveshjes së korrikut 2015.

♦ Vlera 5,240.288.46 USD, detyrimi për gaz natyror në vendburimin e delvinës.

♦ Me vlerë 136,725 USD, detyrimi në kondensat.

Sa më sipër, vlera 10,521,755.37 USD, e pa përfshirë në marrëveshjen e muajit korrik 2015, përbën dëm ekonomik.

Marrëveshja “Për shuarjen, me kompensim të detyrimeve të ndërsjellta ndërmjet Albpetrol SHA,, MF dhe MZHETTS” ndërmjet Albpetrol SHA dhe Kompanisë, në të cilën janë përfshirë disa detyrime, por jo të gjitha detyrimet, është nënshkruar pas dorëzimit të procesverbalit të mbajtur për zbatimin e marrëveshjes me këtë kompani. Albpetrol SHA para daljes së Raportit Përfundimtar të Auditimit, paraqet shkresën e Kompanisë, nr. 243/15, datë 11.09.2015, sipas të cilës merr përsipër të njohë pjesën e mbetur të detyrimeve të pa përfshira në marrëveshjen e muajit korrik 2015. Këto veprime nuk janë bërë si rrjedhojë e respektimit të përcaktimeve në marrëveshjen hidrokarbure, por vetëm pas konstatimeve të KLSH. Pra mund të theksohet se, duhej patjetër ndërhyrja e KLSH për nxjerrjen në pah të problematikës dhe kërkimin e marrjes së masave në mbrojtje të interesave të shtetit (trajtuar më hollësisht në faqet 113-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Në kushtet kur marrëveshja e nënshkruar në muajin korrik 2015 ndërmjet Albpetrol SHA dhe Kompanisë nuk ka marrë formë të plotë ligjore, si pasojë e faktit që kjo marrëveshje nuk ka kaluar për miratim në Këshillin e Ministrave, rekomandojmë amendimin e kësaj marrëveshje duke përfshirë në të të gjitha detyrimet që Kompania ka ndaj Albpetrol SHA, duke përfshirë jo vetëm vlerën e dëmit ekonomik rezultuar nga auditimi në shumën 10,521,755.37 USD, por edhe progresivitetin në vazhdim të penalitetit për mos zbatimin në kohë të marrëveshjes së datës 28.02.2014.

Krahas përfshirjes të të gjitha këtyre detyrimeve në marrëveshje, të përcaktohen afate konkrete për vjeljen e tyre duke përfshirë edhe 7,424,724.89 USD, e cila është përcaktuar të likuidohet brenda 10 ditëve referuar miratimit përfundimtar nga Këshilli i Ministrave.

Deri me datë 31.11.2015

7.2. Marrëveshja me Kompaninë

7.2.a Nga ana e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, në periudhën janar-tetor 2014, është kryer një auditim në lidhje me koston e operacioneve hidrokarbure, për periudhën tetor-dhjetor 2012 dhe janar-tetor 2013. Albpetrol me shkresë nr. 5453/1, datë 14.05.2014, ka njoftuar Kompaninë, në lidhje me mosnjohjen si shpenzime të regjistruara në koston hidrokarbure për periudhën tetor-dhjetor 2012 me vlerë **121,326,000 USD**. Po ashtu, Albpetrol me shkresë nr. 5453/2, datë 26.12.2014, ka kërkuar po nga kjo Kompani, **zbritjen e vlerës 231,187,463 USD**, për periudhën e zhvillimit të operacioneve hidrokarbure janar-shtator 2013. Pavarësisht njoftimit të bërë Kontraktorit, nuk është vepruar akoma për reflektimin e këtyre rezultateve në rishikimin e kostove hidrokarbure.

Bazuar në dokumentacionin në disponim, bilanci të ardhura shpenzime në progresiv nga nënshkrimi i marrëveshjes deri në fund të marsit 2015, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Treguesi progresiv korrik 2004-mars 2015 (000 USD)
1	Të ardhura të kontraktorit	2,312,441
2	Shpenzimet kapitale (Capex)	1,320,696
3	Shpenzimet operative totale (Opex)	1,102,592
4	Shpenzimet në TOTAL (4=2+3)	2,423,288
	Koeficienti R (5=1/4)	0.9543

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë rezultatet e auditimit të ushtruar nga drejtoria e Marrëveshjeve hidrokarbure, si dhe tejkalimin e afatit të paraqitjes së pretendimeve nga ana e Kontraktorit, nga zbritja e vlerës 352,513,463 USD, rezultati financiar do të ishte si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Treguesi progresiv korrik 2004-mars 2015 (000 USD)
1	Të ardhura të kontraktorit	2,312,441
2	Shpenzimet në TOTAL	2,423,288
3	Shpenzimet pas zbritjes së vlerës 352,513 USD	2,070,775
	Fitimi (1-3)	241,666
	Detyrimi për shtetin në masën 50 %	120,833

Duke qenë se, nga zbritja e shpenzimeve si më sipër, koeficienti R rezulton mbi 1, bazuar në Ligjin Nr. 7811, datë 12.04.1994 “Për miratimin e Dekretit Nr. 782, datë 22.02.1994 “Mbi sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve” i ndryshuar, Neni 1, ndarja e fitimit bëhet 50 % për Kontraktorin dhe 50 % për Qeverinë Shqiptare. Në këto kushte, deri në këtë fazë të zbatimit të marrëveshjes hidrokarbure, **Kontraktori i detyrohet Qeverisë Shqiptare vlerën 120,833 mijë USD**, nga rishikimi i koeficientit R i cili pas zbritjeve të kostove hidrokarbure me vlerë 352,513,463 USD, rezulton mbi 1. Vlera e mësipërme i përket periudhës nga fillimi i marrëveshjes në vitin 2004 deri me datë 31.03.2015. Deri me datë 19.09.2015, datë kur është realizuar takimi përfundimtar me Drejtues të Albpetrol SHA Patos, nuk është paraqitur asnjë dokumentacion apo informacion që vërteton shlyerjen e kësaj vlere. Bazuar në nenin 25 të Marrëveshjes Hidrokarbure, Organi i ngarkuar për auditimin e llogarisë kosto është Albpetrol SHA. Bazuar në nenin 19 të marrëveshjes hidrokarbure, çdo konflikt, mosmarrëveshje, pretendim ose ndryshim në opinion duke përfshirë çdo mbyllje të pretenduar, i lindur prej ose lidhur me marrëveshjen, **ose ndaj operacioneve hidrokarbure të kryera**, do të zgjidhen përfundimisht dhe në mënyrë vendimtare **nga arbitrazhi** në përputhje me rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL (rregullat). Bazuar në këto përcaktime, çdo auditim tjetër i këtyre llogarive nga auditues të huaj, do të binte në kundërshtim me marrëveshjen (trajtuar më hollësisht në faqet 134-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të njoftojë dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për marrjen e masave për arkëtimin e 120,833 mijë USD nga Kompania Kjo vlerë rrjedh si detyrim i ndarjes së fitimit në masën 50 % për Qeverinë Shqiptare dhe 50 % për kontraktorin, në zbatim të Ligjit Nr. 7811, datë 12.04.1994 “Për miratimin e Dekretit Nr. 782,

datë 22.02.1994 “Mbi sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve” i ndryshuar, Neni 1, pas zbritjes së shpenzimeve të pa justifikuara përfshirë në kostot hidrokarbure. Kjo vlerë i përket zbritjes së shpenzimeve të pa justifikuara nga ana e Kontraktorit për periudhën shtator 2012 deri shtator 2013, por që reflektohet në kalimin e koeficientit 1 mbi R, në vitin 2014. Refuzimi i shlyerjes së këtij detyrimi pa të drejtë nga ana e kontraktorit do të konsiderohet dëm ekonomik. Ndërsa në rast se ky detyrim pranohet nga kontraktori, por shlyerja e tij (detyrimit) nuk bëhet në kohën e parashikuar në ligj, atëherë vlera mësipërme do të konsiderohet si e ardhur e munguar.

Në zbatim të nenit 25 të marrëveshjes hidrokarbure, Albpetrol SHA nuk duhet të marrë në konsideratë rezultatet e asnjë auditimi tjetër në lidhje me auditimin e llogarive kosto hidrokarbure. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me kostot hidrokarbure, duhet të bazohet në nenin 19 të marrëveshjes hidrokarbure, e cila përcakton si rrugë të vetme arbitrazhin (UNCITRAL) dhe jo riauditime. Bazuar në ligjin e mësipërm, të merren masa që çdo ankimim i mundshëm të bëhet pas shlyerjes së detyrimeve, mbështetur në legjislacionin tatimor në Republikën e Shqipërisë dhe kërkesave të Marrëveshjes së Hidrokarbureve.

Menjëherë

7.2.b Duke filluar nga viti 2011, Kontraktori ka krijuar detyrime nga ndarja e prodhimit pjesë e Albpetrol. Deri me datë 31.03.2015, sasia e naftës që është krijuar për likuidim është në sasinë 39,220.31 Ton. Kjo sasi, bazuar në çmimin e shitjes nga kontraktori sipas periudhës së lindjes së detyrimit dhe në zbatim të VKM nr. 947, datë 29.12.2014, Pika 2., vlerësohet në shumën **15,679,297.2 USD** (trajtuar më hollësisht në faqet 136-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për vjeljen e detyrimit nga Kompania me vlerë 15,679,297.2 USD, i cili vjen nga mos dhënia e sasisë së naftës brut për pjesën e Albpetrol në sasinë 39,220.31 ton, detyrim i akumuluar për periudhën janar 2011 deri në mars 2015.

Deri me datë 31.12.2015

7.3. Marrëveshje me Kompaninë

Kompania për periudhën e zbatimit të marrëveshjes hidrokarbure deri në fund të tre mujorit të parë 2015, i detyrohet Albpetrol naftë brut në sasinë 2,940.1 ton. Kjo sasi, referuar çmimit të shitjes sipas vitit përkatës të lindjes së detyrimit, përlllogarit me **vlerë 99,731,683.5 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 144-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për vjeljen e detyrimit që kontraktori ka akumuluar, si pjesë nga ndarja e prodhimit të përcaktuar në marrëveshje me vlerë 99,731,638.5 lekë ose 785,288.5 USD, për sasinë 2940.1 ton.

Deri me datë 31.12.2015

7.4. Marrëveshja me kompaninë

Detyrimi i prodhimit paraekzistues (PPE) dhe pjesa e Albpetrol (PPA), i pa dorëzuar shoqërisë Albpetrol datë 31.03.2015 është në sasinë 1,584.4 ton naftë bruto.

Sipas përlllogaritjeve nga Drejtoria e Financës pranë Albpetrol, deri me datë 31.12.2014, Kompania i detyrohet Albpetrol vlerën 25,266,860.92 lekë, por këto llogaritje nuk janë referuar në çmimin e shitjes së Kontraktorit në periudhën e lindjes së detyrimit. Bazuar në këtë çmim, sasia 1,584.4 ton që Kompania i detyrohet Albpetrol është në shumën 60,124,422.6 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 145-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për vjeljen e detyrimit që kontraktori ka akumuluar, si pjesë nga ndarja e prodhimit të përcaktuar në marrëveshje në naftë brut me vlerë 60,124,422.6 lekë ose 473,420 USD, për sasinë 1,584.4 ton.

Deri me datë 31.12.2015

7.5 Marrëveshja me Kompaninë

Detyrimi i prodhimit para ekzistues (PPE) dhe pjesa e Albpetrol për naftën brut (PPA), i pa dorëzuar shoqërisë Albpetrol deri me datë 31.03.2015, është 1,455.5 ton me vlerë 47,962,551.5 lekë, ndërsa detyrimi për gazin natyror është në sasinë 371,428.3 Nm³ me vlerë 12,999,991 lekë (trajtuar më hollësisht në faqen 148-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për vjeljen e detyrimit që kontraktori ka akumuluar, si pjesë nga ndarja e prodhimit të përcaktuar në marrëveshje me vlerë totale 60,962,542.7 lekë ose 477,894 USD, për sasinë naftë brut 1,455.5 ton, dhe gaz natyror 371,428.3 Nm³.

Deri me datë 31.12.2015

C. MASA DISIPLINORE

I. Këshilli Mbikëqyrës të analizojë Raportin Përfundimtar dhe rekomandimet e auditimit të mëparshëm në mbledhjen më të afërt dhe të raportojë me shkrim në KLSH mbi arsyet e mos zbatimit të këtyre masave, veçanërisht për masat disiplinore në ngarkim të z. dhe z. Më tej KLSH do analizojë këtë material të Këshillit Mbikëqyrës dhe do t'i drejtohet organeve më të larta shtetërore të kompetencës si dhe atij të prokurorisë, në se do të jetë e nevojshme, sipas përcaktimit në Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Neni 15.

II. Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, i kërkojmë Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol SHA, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

“Largim nga detyra”, për:

z., me detyrë Administrator i Albpetrol SHA, sepse:

Nuk ka marrë masat e duhura në zbatim të marrëveshjes hidrokarbure, për të kërkuar miratimin e transferimit të interesave nga Kompania tek, për plotësimin e kriterëve nga ana e Kontraktorit në zbatim të Pikës 16.1 dhe 16.3, të marrëveshjeve hidrokarbure. Ky veprim i ka shkaktuar Albpetrol si palë e licencuar humbje të konsiderueshme me vlera që kalojnë 10,521,755.37 USD, vlerë e cila është konsideruar dëm ekonomik. Pavarësisht se pas realizimit të auditimit Albpetrol SHA ka paraqitur një shkresë ku njeh detyrimet e Kontraktorit velrat e mësipërme nuk janë përfshirë në marrëveshjen e muajit korrik 2015 (marrëveshje e nënshkruar pas dorëzimit të procesverbalit të grupit të auditimit të KLSH nr. 1, datë 21.07.2015).

-Nuk ka marrë masat e duhura për të kërkuar nga kontraktorët shlyerjen e detyrimeve që ato kanë ndaj Albpetrol për naftë brut dhe gaz.

- Nga ana e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, në periudhën janar-tetor 2014, është kryer një auditim në lidhje me koston e operacioneve hidrokarbure, për periudhën tetor-dhjetor 2012 dhe janar-tetor 2013. Albpetrol me shkresë nr. 5453/1, datë 14.05.2014, ka njoftuar Kompaninë, në lidhje me mosnjohjen si shpenzime të regjistruara në koston hidrokarbure për periudhën tetor-dhjetor 2012 me vlerë **121,326,000 USD**. Po ashtu, Albpetrol

me shkresë nr. 5453/2, datë 26.12.2014, ka kërkuar po nga kjo Kompani, **zbritjen e vlerës 231,187,463 USD**, për periudhën e zhvillimit të operacioneve hidrokarbure janar-shtator 2013. Pavarësisht njoftimit, deri në këtë periudhë rezulton se, këto vlera nuk janë zbritur ende nga kostot e operacioneve hidrokarbure. Gjithashtu nuk ka njoftim për organet përkatëse, për vlerën e detyrimit që rrjedh nga ky veprim, për përfitimin që i takon Qeverisë Shqiptare. Po ashtu, nuk ka marrë masat e duhura për evadimin në kohë të auditimit.

-Ka miratuar amendimin e kontratës nr. 6591/10, datë 26.12.2014, lidhur me OE, duke zgjatur me 1 muaj afatin e përfundimit të kontratës, në kundërshtim me kontratën nr. 6591/5, datë 27.11.2014, të lidhur midis palëve. Nga ky veprim shoqërisë Albpetrol SHA i është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,765,930 lekë, si pasojë e mos-përlllogaritjes së dëmeve të likuiduara për dorëzimin e vonuar, në zbatim të kontratës nr. 6591/5, datë 27.11.2014, shtojca 13, neni 24.1.a.

Kjo masë do t'i komunikohet Këshillit Mbikëqyrës, mbasi të auditohet dhe të vlerësohet nga KLSH, puna dhe veprimtaria që Administratori i shoqërisë, do të ndërmarrë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve dhe marrjen e masave disiplinore për drejtuesit dhe punonjësit e Albpetrol SHA.

III. Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratën kolektive të punës nr. 1655, datë 30.05.2012, kërkojmë nga Administratori i Shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

“Largim nga puna” për:

1. z., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, sepse:

-Nuk ka marrë masat e duhura në zbatim të marrëveshjes hidrokarbure, për të kërkuar miratimin e transferimit të interesave nga Kompania tek, duke plotësuar më parë shlyerjen e detyrimeve në zbatim të Pikës 16.1 dhe 16.3, të marrëveshjeve-hidrokarbure. Ky veprim i ka shkaktuar Albpetrol si palë e licencuar humbje të konsiderueshme me vlera që kalojnë 10,521,755.37 USD, vlerë e cila nuk është garantuar për likuidim nga Kontraktori deri në përfundim të auditimit. Pavarësisht se në marrëveshjen e muajit korrik 2015 është përfshirë një pjesë e detyrimeve, nuk janë marrë masa për përfshirjen e plotë të tyre.

- Nga ana e Drejtorisë Hidrokarbure nuk janë marrë masat e duhura të parashikuara në Artikullin 24.2, të Marrëveshjeve Hidrokarbure, për të bërë paralajmërimet për thyerje të marrëveshjeve kryesisht në akumulimin e detyrimeve nga Kontraktorët.

Nuk ka marrë masat e duhura për të kërkuar nga kontraktorët shlyerjen e detyrimeve që ato kanë ndaj Albpetrol për naftë brut dhe gaz.

- Nga ana e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, në periudhën janar-tetor 2014, është kryer një auditim në lidhje me koston e operacioneve hidrokarbure, për periudhën tetor-dhjetor 2012 dhe janar-tetor 2013. Duke qenë se auditimi i koston së operacioneve hidrokarbure të Kontraktorit është bërë nga Drejtoria Hidrokarbure, nuk janë marrë masa për zbritjen e shpenzimeve të panjohura nga Albpetrol, për të njoftuar më tej organet tatimore, për detyrimin e pjesës fitim për Qeverinë Shqiptare që lind nga ky veprim.

2. z., me detyrë përgjegjës i sektorit Juridik, pranë Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, sepse:

-Nuk ka marrë masat e duhura në zbatim të marrëveshjes hidrokarbure, për të kërkuar kërkuar dhe dhënë miratimin juridik për transferimin e interesave nga Kompania tek Dokumentacioni i ardhur nga AKBN duhet të shqyrtohet dhe duhet të paraqiteshin objeksionet e transferimit të interesave nga një kompani tek tjetra, duke plotësuar më parë përcaktimet e Pikës 16.1 dhe 16.3, të marrëveshjeve-hidrokarbure. Ky veprim i ka

shkaktuar Albpetrol si palë e licencuar humbje të konsiderueshme me vlera që kalojnë 10,521,755.37 USD, vlerë e cila nuk është përfshirë në marrëveshjen, nënshkruar ndërmjet Albpetrol SHA dhe Kontraktorit në korrik 2015.

- Nga ana e Drejtorisë Hidrokarbure nuk janë marrë masat e duhura të parashikuara në Artikullin 24.2, të Marrëveshjeve Hidrokarbure, për të bërë paralajmërimet për thyerje të marrëveshjeve kryesisht në akumulimin e detyrimeve nga Kontraktorët.

Nuk ka marrë masat e duhura për të kërkuar nga kontraktorët shlyerjen e detyrimeve që ato kanë ndaj Albpetrol për naftë brut dhe gaz.

- Nga ana e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, në periudhën janar-tetor 2014, është kryer një auditim në lidhje me koston e operacioneve hidrokarbure, për periudhën tetor-dhjetor 2012 dhe janar-tetor 2013. Duke qenë se auditimi i koston së operacioneve hidrokarbure të Kontraktorit është bërë nga Drejtoria Hidrokarbure, nuk janë marrë masa për zbritjen e shpenzimeve të panjohura nga Albpetrol, për të njoftuar më tej organet tatimore, për detyrimin e pjesës fitim për Qeverinë Shqiptare që lind nga ky veprim.

3. z., me detyrë përgjegjës i sektorit Ekonomik, pranë Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, sepse:

- Nga ana e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, në periudhën janar-tetor 2014, është kryer një auditim në lidhje me koston e operacioneve hidrokarbure, për periudhën tetor-dhjetor 2012 dhe janar-tetor 2013. Megjithëse nga auditimi nuk janë njohur dhe është rekomanduar zbritja e shpenzimeve të kostove hidrokarbure me 121,326,000 USD dhe vlerë 231,187,463 USD, nga ana e përgjegjësit të Sektorit Ekonomik, nuk janë marrë masa për përlogaritjen e koeficientit R, i cili pas zbritjeve të vlerave të mësipërme rezulton mbi 1, pra lindin detyrime për ndarjen e fitimit mes Kontraktorit dhe Qeverisë Shqiptare.

Në lidhje me detyrimet e kontraktorëve nuk janë bërë llogaritjet për vlerën e sasive të naftës brut, detyrim ndaj Albpetrol, sipas çmimit të shitjes që ato kanë realizuar në periudhën e lindjes së detyrimeve. Likuidimi i detyrimeve në natyrë në këtë periudhë ku çmimi i naftës brut në bursa është shumë më i ulët se ai i shitjes së kontraktorëve në periudhën e lindjes së detyrimeve, do të shkaktonte humbje të mëdha për Albpetrol SHA.

4. z. me detyrë ish-drejtor i QASHNG Patos për periudhën 04.11.2013-31.10.2014 dhe drejtor i Qendrës së Transportit Patos për periudhën 31.10.2014 e në vazhdim, për arsye se:

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Shërbim me Vaccum Truck”, kanë kualifikuar bashkimin e operatorëve Ekonomikë edhe pse operatori, nuk ka sjellë realizim të punimeve të ngjashme, ndërsa operatori ka paraqitur dokumentacion të punimeve të ngjashme i cili që ka të bëjë me dhënia me qira autosonda, si dhe shërbim autosonde, të cilat nuk përfshihen si të ngjashme. Kjo shoqëri nuk ka në disponim automjet “Vaccum truck”.

Kualifikimi i operatorit ekonomik pa plotësuar dokumentacionin e kërkuar për punime të ngjashme nga dy operatorët është në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VII, Pika 2.2.b. Për këtë veprim mban përgjegjësi KVO.

Operatori Ekonomik, nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e energjisë elektrike, veprim në kundërshtim me dokumentet e tenderit, shtojca 7, pika 2.2.c.

Operatori, nuk ka paraqitur vërtetim për gjendjen bankare, në kundërshtim me shtojcën 7, pika 2.2.b të dokumenteve të tenderit.

-Për grup mallrat e ngjashme në blerjet me vlera të vogla është tejkaluar limiti ligjor prej 400,000 lekë për vitin 2014 dhe 800,000 lekë për vitin 2015. Për pasojë duhet të ishin zhvilluar procedurat përkatëse të prokurimit.

-Në kërkesën nr. 584 prot, datë 26.01.2015, e bërë nga drejtori i Qendrës së Transportit, nuk është përcaktuar qartë nevoja e kryerjes së procedurës “Shërbim i sigurimit full kasko për mjetet e reja” me vlerë 3,969,584 lekë pa tvsh, si dhe nuk ka kryer më parë një analizë ekonomiko-financiare e cila të argumentonte përparësitë e kryerjes së kësaj procedure, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26.

-Për miratimin e zbritjes së normave të firove ligjore nga bilanci i muajve Gusht dhe Tetor, është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat””, i ndryshuar.

“Paralajmërim për pushim nga puna” për:

1. z.,

2. znj.,

3. z., me detyrë anëtarë të KVO, sepse:

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje pajisje laboratorike”, kanë kualifikuar bashkimin e operatorëve dhe, edhe pse në tender kanë rezultuar me mangësi.

Për disa pajisje është marrë autorizim nga shpërndarësi dhe jo prodhuesi, veprim në kundërshtim me kriteret e veçanta të dokumenteve të tenderit, pika 2.1.c. z., ka marrë pjesë si anëtar i KVO edhe në tenderin “Shërbim me Vaccum Truck”, nga ku ka rezultuar se, gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Shërbim me Vaccum Truck”, KVO ka kualifikuar bashkimin e operatorëve Ekonomikë edhe pse operatori, nuk ka sjellë realizim të punimeve të ngjashme, ndërsa operatori ka paraqitur dokumentacion të punimeve të ngjashme i cili që ka të bëjë me dhënia me qira autosonda, si dhe shërbim autosonde, të cilat nuk përfshihen si të ngjashme. Kjo shoqëri nuk ka në disponim automjet “Vaccum truck”.

4. Znj.,

5. z.,

6. z.,

7. znj., me detyrë anëtarë të komisionit të marrjes në dorëzim, sepse:

Gjatë zbatimit të Kontratës së Furnizimit “Blerje pajisje laboratorike”, kanë marrë në dorëzim materialet pa bërë kolaudimin përkatës për 40 % të pajisjeve, në kundërshtim me Kontratën e furnizimit, Nenin 4, Pika 4.b.

z., në cilësinë e anëtarit të komisionit të kolaudimit për procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje veshmbathje për punëtorët”, ka kryer kolaudimin e mallrave me vlerë 16,351,200 lekë me tvsh, të cilat kanë si vend origjine ndryshe nga sa ishte deklaruar në ofertën dhe kontratën e lidhur midis palëve.

znj. cilësinë e anëtares së Këshillit Teknik QASHNG Patos, për miratimin e zbritjes së normave të firove ligjore nga bilanci i muajve Gusht, Tetor dhe Nëntor, në kundërshtim me VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat””, i ndryshuar. Në total, për periudhën 01.07.2014-31.12.2014, sasia e naftës bruto që është zbritur nga bilanci në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, është 120.94 ton, sasi e cila po të shumëzohet me çmimin e brendshëm të përdorur nga QASHNG Patos 18,634 lekë/ton, është në vlerën **2,253,595.96 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për llogari të Albpetrol SHA.

8. z.,

9. z.,

10. z., me detyrë anëtarë të Njesisë së Prokurimit, sepse:

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Shërbim me Vaccum Truck”, në kriteret që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë është edhe disponim i një automjeti “Vaccum truck” me vit prodhimi para vitit 1995. Vendosja e këtij kriteri ka bërë përjashtim të mundshëm të operatorëve të cilët mund të kenë automjetet me vit prodhimi para 1995. Ky veprim bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Neni 20.

11. z., me detyrë anëtar i KVO, sepse:

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Shërbim me Vaccum Truck”, kanë kualifikuar bashkimin e operatorëve Ekonomikë edhe pse operatori, nuk ka sjellë realizim të punimeve të ngjashme.

Kualifikimi i operatorit ekonomik pa plotësuar dokumentacionin e kërkuar për punime të ngjashme nga dy operatorët është në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VII, Pika 2.2.b. Për këtë veprim mban përgjegjësi KVO.

12. z.,

13. znj.,

14. z.,

Në cilësinë e anëtarëve të komisionit të shitjes, për ankandin e shitjes së sasisë 100,000 ton naftë brut, për arsye se:

-Formulari i njoftimit të ankandit nr. 3768/1, datë 30.04.2015, nuk është botuar në buletin e APP, në kundërshtim me Ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, neni 23, të ndryshuar, neni 23.

-Formulari i njoftimit të Ankandit nuk është publikuar në gazetë ndërkombëtare me shpërndarje në Evropë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, neni 23 dhe VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, të ndryshuar, Kreu III, pika 3.3, germa b.

-Në përcaktimin e datës së hapjes së ankandit (08.05.2015), është lënë një afat 8 ditor për dorëzimin e ofertave, duke mos marrë parasysh kufirin minimal prej 20 ditësh nga data e njoftimit të ankandit (data 30.04.2015), e për pasojë data më e hershme e mundshme për hapjen e ofertave, duhet të ishte data 20.05.2015. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, neni 28.

-Në DSA e miratuara, shtojca 5, pika 2, germa i), është kërkuar që kandidati blerës të paraqesë një vërtetim që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të faturuara të energjisë elektrike, kërkesë e cila nuk është e parashikuar në Ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar.

-Për kualifikimin dhe shpalljen fituese të ofertës së OE, dhe pse ky OE në datën e zhvillimit të tenderit ka detyrime financiare ndaj Albpetrol në vlerën 381,9126,905 lekë, në kundërshtim me Urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure (naftë bruto)”, i ndryshuar, pika 11.

-z. për miratimin e zbritjes së normave të firove ligjore nga bilanci i muajve Gusht, Tetor dhe Nëntor, në kundërshtim me VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, i ndryshuar. Në total, për periudhën 01.07.2014-31.12.2014, sasia e naftës bruto që është zbritur nga bilanci në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, është 120.94 ton, sasi e cila po të shumëzohet me çmimin e brendshëm të përdorur nga QASHNG Patos 18,634 lekë/ton, është në vlerën **2,253,595.96 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për llogari të Albpetrol SHA.

15. z., me detyrë drejtor juridik, për arsye se:

-Ka hartuar amendimin e kontratës nr. 6591/10, datë 26.12.2014, lidhur me OE, duke zgjatur me 1 muaj afatin e përfundimit të kontratës, në kundërshtim me kontratën nr. 6591/5, datë 27.11.2014, të lidhur midis palëve. Nga ky veprim shoqërisë Albpetrol SHA i është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,765,930 lekë, si pasojë e mos-përllogaritjes së dëmeve të likuiduara për dorëzimin e vonuar, në zbatim të kontratës nr. 6591/5, datë 27.11.2014, shtojca 13, neni 24.1.a.

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të shitjes, për ankandin e shitjes së sasisë 100,000 ton naftë brut, për arsye se:

-Formulari i njoftimit të ankandit nr. 3768/1, datë 30.04.2015, nuk është botuar në buletin e APP, në kundërshtim me Ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, neni 23, të ndryshuar, neni 23.

-Formulari i njoftimit të Ankandit nuk është publikuar në gazetë ndërkombëtare me shpërndarje në Evropë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, neni 23 dhe VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, të ndryshuar, Kreu III, pika 3.3, germa b.

-Në përcaktimin e datës së hapjes së ankandit (08.05.2015), është lënë një afat 8 ditor për dorëzimin e ofertave, duke mos është marrë parasysh kufiri minimal prej 20 ditësh nga data e njoftimit të ankandit (data 30.04.2015), e për pasojë data më e hershme e mundshme për hapjen e ofertave, duhet të ishte data 20.05.2015. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, neni 28.

-Për kualifikimin dhe shpalljen fituese të ofertës së OE, dhe pse ky OE në datën e zhvillimit të tenderit ka detyrime financiare ndaj Albpetrol në vlerën 381,9126,905 lekë, në kundërshtim me Urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure (naftë bruto)”, i ndryshuar, pika 11.

16. z.,

17. z.,

Në cilësinë e anëtarëve të komisionit të kolaudimit për procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje veshmbathje për punëtorët”, për arsye se:

Kanë kryer kolaudimin e mallrave për procedurën “Blerje veshmbathje për punëtorët” me vlerë 16,351,200 lekë me tvsh, të cilat kanë si vend origjine ndryshe nga sa ishte deklaruar në ofertën dhe kontratën e lidhur midis palëve.

18. z.,

19. znj.,

20. z.,

21. znj.,

Në cilësinë e anëtarëve të Këshillit Teknik QASHNG Patos, për arsye se:

-Për miratimin e zbritjes së normave të firove ligjore nga bilanci i muajve Gusht, Tetor dhe Nëntor, në kundërshtim me VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat””, i ndryshuar. Në total, për periudhën 01.07.2014-31.12.2014, sasia e naftës bruto që është zbritur nga bilanci në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, është 120.94 ton, sasi e cila po të shumëzohet me çmimin e brendshëm të përdorur nga QASHNG Patos 18,634 lekë/ton, është në vlerën **2,253,595.96 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për llogari të Albpetrol SHA.

22.,

23., anëtarë të KVO, për arsye se:

Në procedurën e prokurimit “Blerje shkume sintetike, pluhurshuarëse” kanë kualifikuar operatorin ekonomik, edhe ky operator nuk ka plotësuar kriterin e përcaktuar në

DST përse i përket numrit të punonjësve për periudhën janar-tetor 2014. Gjithashtu, formati i konfliktit të interesit nuk është dorëzuar sipas standardeve të APP-së, fakt ky i cili, në raste të tjera KVO-ja e ka përdorur për s'kualifikimin e operatorëve ekonomik.

Në procedurën e zhvilluar me objekt "Blerje panele elektrik", KVO ka kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomik &, megjithëse nuk ishte plotësuar kriteri i përcaktuar në DST, përse i përket numrit të punonjësve për periudhën janar-tetor 2014. në kundërshtim me shtojcën 7 të DST.

24., anëtare KVO, për arsye se:

Në procedurën e zhvilluar me objekt "Blerje panele elektrik", KVO ka kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomik &, megjithëse nuk ishte plotësuar kriteri i përcaktuar në DST, përse i përket numrit të punonjësve për periudhën janar-tetor 2014. në kundërshtim me shtojcën 7 të DST.

"Vërjetje", për:

1. Znj me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Ruajtjes dhe Administrimit të pronës, sepse:

-Nuk ka zbatuar VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë", dhe udhëzimit në zbatim të tij Udhëzimit të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 906, datë 21.11.2011 dhe nr. 4, datë 14.06.2012 "Për zbatimin e VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë" në lidhjen e kontratës me Shoqërinë, jashtë kompetencave të Albpetrol SHA.

- si dhe lidhjen e kontratës me z. pasi nuk ka ndjekur procedurat e marrjes së informacionit nga qendra përkatëse për detyrime të papaguara prej tij për periudhën në administrim të pronës po pa kontratë, në shumën prej 87,000 lekë . Kjo sasi përbën të ardhur të munguar në llogarinë e shoqërisë.

2. Znj. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës,

3. Znj. me detyrë K/specialiste në Drejtorinë e Financës, sepse:

Për mangësitë e rezultuara në dokumentacionin e paraqitur nga qendrat vartëse të Albpetrol SHA për auditimin e pasqyrave financiare të secilës prej tyre, si dhe tejkallimit të afateve të hartimit dhe miratimit të këtyre pasqyrave, duke çuar në tejkallimin e afateve ligjore të përcaktuara në dorëzimin e pasqyrave financiare në organet tatimore të shoqërisë Albpetrol SHA për vitin 2013 dhe 2014.

4.,

5.,

6.,

7., anëtarë të grupit të kolaudimit, për arsye se:

Gjatë kolaudimit të mallit, sipas procedurës "Blerje kallaj", lingotat e marra në dorëzim nga komisioni i kolaudimit nuk përmbushin kriteret e kërkuara sipas specifikimeve teknike dhe konkretisht përmbajtja në % e përbërësit "Cu", e cila nuk duhet të kalojë vlerën 0.015 %. Në dokumentet e dorëzuara kjo vlerë shkon nga 0.74 % deri 0.81 %. Gjithashtu nuk jepen të dhëna për përmbajtjen e përbërësve të tjerë si As, Fe, Bi, Sb dhe S.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në shkeljet e konstatuara si dhe në Kodin penal, neni 164 për shpërdorimin e kompetencave dhe nenin 248, për shpërdorimit të detyrës, KLSH ka depozituar pranë

Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, kallëzimin penal nr. 494/21, datë 03.12.2015, respektivisht për z., me detyrë Drejtor i QPNG Patos për moskryerje të detyrave funksionale (me dashje apo pa dashje) në lidhje me administrimin dhe ruajtjen e pronës së shoqërisë si dhe një sërë shkeljesh të dispozitave ligjore e nënligjore të kësaj fushe dhe më konkretisht:

Për moskryerje të detyrave funksionale (me dashje apo pa dashje) në lidhje me administrimin dhe ruajtjen e pronës shtetërore në administrim të Albetrol -sha me pasojë vjedhjen e rërës bituminoze në masën 22,379 ton dhe në vlerën kontabile 16,104,670 lekë të rezultuar si mungesë inventariale në pasqyrat financiare të vitit 2014 dhe të identifikuara në procesverbalet e inventarëve të kryera për qendrën QPN Patos.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezultoi se nga administratori i shoqërisë dhe drejtuesi i qendrës për ngjarjen e ndodhur dhe të pretenduar si vjedhje, e cila ka ndodhur në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve 2012, 2013, 2014 por e konstatuar në kontabilitet në vitin 2014, nuk ka marrje masash për ngritjen e një sistemi të sigurt ruajtje dhe mbrojtjeje të aktiveve në zbatim të akteve në fuqi, nuk ka nxjerrje përgjegjësish, nuk ka ndjekje ose denoncime hap, pas hapi në organet kompetente dhe në rastet e hapjes së çështjeve penale shumë kohë pas fakteve të ndodhura, argumentet bazë të denoncimeve nuk janë shoqëruar me dokumente vërtetues, por vetëm mbi baza hipotezash. Për këtë arsye çdo herë kallëzimet penale janë pushuar nga prokuroria. Për sa më sipër ka rezultuar se nga administrata e Albpetrol SHA si nga ajo e QPNGR, ashtu dhe nga Drejtoria e Albpetrol SHA nuk janë ndjekur procedurat ligjore dhe të besueshme të denoncimit të vjedhjeve hap pas hapi, nuk janë marrë masat e nevojshme në mënyrë të vazhdueshme për ruajtjen dhe administrimin e aseteve materiale dhe nuk janë përcaktuar përgjegjësitet për punonjësit me përgjegjësi funksionale të ruajtjes së asetit si dhe punonjësve me përgjegjësi materiale të asetit.

E. TË TJERA

- Ky auditim është vlerësuar nga Kryetari i KLSH jo në përputhje me pritshmëritë për sa i përket auditimit të prokurimeve të zhvilluara në Albpetrol SHA. Në auditimin e radhës, do të riauditohet kjo periudhë auditimi, për sa më sipër.
- Për Marrëveshjet Hidrokarbure do iniciohet një auditim i veçantë performance.
- Nisur nga ankesat e banorëve të zonës Marinëz që janë depozituar në KLSH, në të ardhmen KLSH do iniciojë një auditim tematik për këtë çështje, në bashkëpunim me Auditin e Brendshëm të Albpetrol SHA dhe AKBN-së.
- Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Departamenti Juridik dhe Kontrollit të Standarteve, të shikojnë mundësinë për përgatitjen e ndryshimeve në Ligjin Nr. 7811, datë 12.04.1994 “Për miratimin e Dekretit Nr. 782, datë 22.02.1994 “Mbi sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve”, ndryshuar me Ligjin Nr. 8345, datë 13.05.1998, Nr. 10049, datë 24.12.2008, Ligjin Nr. 32/2012, datë 21.03.2012, Ligjin Nr. 183/2013, datë 28.12.2013.

Brenda vitit 2015

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Artan Topjana, Nikoleta Piranjani, Alfons Gabili, Dritan Kore dhe Altin Tafilaj, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Iliazi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT